



de Rechtspraak



Ministry of Foreign Affairs of the Netherlands

PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË TRAFIKUAR NË SHQIPËRI

ANALIZË LIGJORE E SITUATËS AKTUALE NË
LIDHJE ME TË DREJTAT E VIKTIMAVE TË
TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE



PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË TRAFIKUAR NË SHQIPËRI

ANALIZË LIGJORE E SITUATËS AKTUALE NË LIDHJE ME TË DREJTAT E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Përgatitur në kuadrin e projektit "Promovimi i qasjes me në qendër viktimën në rastet e trafikimit në Shqipëri dhe Bosnje-Hercegovinë", me mbështetjen financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës, programi Matra CoProl (DEU 25469).

Tiranë 2015

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit ***“Promovimi i qasjes me në qendër viktimën në rastet e trafikimit në Shqipëri dhe Bosnje-Hercegovinë”***, me mbështetjen financiare të Ministrisë Holandeze të Punëve të Jashtme, programi Matra CoProl (DEU 25469).

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare-QNL

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen e botuesit.

Përgatitën raportin:

Av.Besa Saraci, Jonida Gezka, Erviola Stoja, Aurela Bozo.

Arti grafik:

Elvis Bejtja

Redaktore letrare:

Gjylso Binaj

Botues:

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

Nëse jeni të interesuar për këtë botim, mund të kontaktoni me ne, në adresën:

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare- QNL

ISBN:

Adresa:

“Vaso Pasha”, Pall.12, shk.1, Ap.1, Tiranë-Shqipëri.

Tel:+355 4 2259795

Web: www.qag-al.org

PËRMBAJTJA E LËNDËS

PARATHËNIE	4
HYRJE	6
PJESA 1 – FAKTE DHE TË DHËNA	9
PJESA 2 – LEGJISLACIONI PENAL	18
2.1. Trafikimi i qenieve njerëzore	18
2.2. Puna e detyruar, skllavëria, praktika të ngjashme me skllavërinë dhe servituti	24
2.3. Prostitucioni	25
2.4. Publikimi i praktikës gjyqësore.....	33
PJESA 3 – POZITA E PËRGJITHSHME E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE NË PROCESIN PENAL	35
PJESA 4 – AKSESI TEK NDIHMA LIGJORE DHE PËRFAQËSIMI LIGJOR	43
PJESA 5 – TË DREJTAT E VIKTIMËS	51
5.1. E drejta për informacion	51
5.2. E drejta për të mos bashkëpunuar me organet e zbatimit të ligjit.....	55
5.3. E drejta për mbrojtjen e privatësisë dhe sigurisë përpara, gjatë dhe pas procedimit penal, si dhe për t’u trajtuar me respekt dhe dinjitet.....	58
5.4. E drejta për kompensim.....	67
5.5. Mosprocedimi dhe mosndëshkimi i personave të trafikuar	73
5.6. Mosndalimi i personave të trafikuar	74
5.7. Periudha e reflektimit, leja e përkohshme dhe e përhershme e qëndrimit dhe azili.....	75
5.8. Rikthimi në atdhe dhe garantimi i mospërsëritjes	76
PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIME	77
ANEKSI 1	80
Roli i OJF-ve. Praktika e Qendrës psikosociale „Vatra“.....	80
Bibliografia	84

PARATHËNIE

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka kënaqësinë të prezantojë një analizë të situatës ligjore mbi statusin e viktimave të trafikimit në Shqipëri, me qëllim që të vlerësohet promovimi dhe garantimi i të drejtave të tyre. Kjo analizë është pjesë e projektit “Promovimi i qasjes me në qendër viktimën në rastet e trafikimit në Shqipëri dhe Bosnje-Hercegovinë”, zbatuar në bashkëpunim midis Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, Komitetit Holandez të Helsinkit, Shkollës Shqiptare të Magjistraturës dhe Qendrës Holandeze të Trajnimeve dhe Studimeve për Gjyqësorin. Ky projekt është mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës, në kuadrin e programit Matra CoProl (DEU 25469).

Mbrojtja e viktimave dhe parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore është qëllimi kryesor i legjislacionit shqiptar, me të cilin lidhet një zhvillim dhe përmirësim i vazhdueshëm i këtij legjislacioni, në mënyrë të veçantë në 15 vitet e fundit. Ky zhvillim i dedikohet në mënyrë të veçantë, forcimit të standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe rritjes së detyrimeve e përgjegjësi të shtetit shqiptar që burojnë nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara për parandalimin e këtij krimi. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe të drejtës së Bashkimit Evropian në këtë fushë, e cila dikton edhe përqasjen e legjislacionit shqiptar me të.

Analiza fokusohet në trajtimin e personave të trafikuar si viktimë gjatë procesit penal dhe proceseve të tjera, në sanksionimin dhe respektimin e të drejtave të tyre procedurale, aksesin e tyre ndaj ndihmës ligjore dhe përfaqësimit në gjykatë, të drejtën e tyre për informim, të drejtën e sigurisë dhe privatësisë, të drejtën për kompensim, etj.

Analiza është fokusuar në vlerësimin e legjislacionit shqiptar, masave ligjore, politikave shtetërore të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë, praktikave

gjyqësore dhe praktikave administrative, me etalon standardet ndërkombëtare. Raporti identifikon mospërputhjet që ekzistojnë midis legjislationit që sanksionon të drejtat e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore nga njëra anë, dhe veprimtarisë për garantimin e këtyre të drejtave në praktikë.

Në përgatitjen e raportit u jemi referuar edhe raporteve të përgatitura nga organizatat e tjera shqiptare, organizatat ndërkombëtare dhe institucionet shtetërore. Pjesë e kësaj analize janë edhe të dhënat e publikuara nga Ministria e Drejtësisë mbi ndjekjen penale të veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore dhe rasteve të trafikimit për punë të detyruar, prostitucionit, shfrytëzimit të prostitucionit etj.

Qëllimi ynë ka qenë që ky raport analitik të shërbejë për profesionistët e drejtësisë, si gjyqtarë, prokurorë, oficerë të policisë, përfaqësues të organizatave jofitimprurëse dhe hartues të politikave, me qëllim përmirësimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor, duke promovuar një qasje të re, e cila ka në qendër vetë viktimën. Ajo do t'i shërbejë rritjes së kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në fushën e hetimit, ndjekjes penale dhe dhënies së dënimit për çështje të trafikimit të qenieve njerëzore, në përputhje me standardet e BE-së, me një vëmendje të veçantë në përmirësimin e pozitës dhe trajtimin e viktimave dhe viktimave/dëshmitare në proceset gjyqësore. Gjithashtu, çështje të kësaj analize do të integrohen në kurrikulën e Shkollës së Magjistraturës për gjyqtarët dhe prokurorët.

Duke uruar që raporti të jetë i dobishëm për të gjithë lexuesit, në emër të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët që ndihmuan në realizimin e këtij studimi, dhe të këtij projekti në tërësi, veçanërisht Komitetin Holandez të Helsinkit, Shkollën Shqiptare të Magjistraturës dhe Shkollën Holandeze të Magjistraturës.

Ju faleminderit,
Prof.dr. Aurela Anastasi
Drejtoreshë ekzekutive

HYRJE

Kjo analizë ligjore për promovimin e të drejtave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore ka si qëllim të vlerësojë situatën aktuale të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore dhe trajtimin e tyre si viktimë/dëshmitarë në procesin penal dhe ndjekjen penale.

Analiza fokusohet në trajtimin e personave të trafikuar si viktimë gjatë procesit penal apo proceseve të tjera, aksesin e tyre në ndihmë ligjore dhe përfaqësim, të drejtën për informim, të drejtën e sigurisë dhe privatësisë, të drejtën për kompensim, etj.

Analiza është bazuar në standardet minimale që përmban Protokollin e Kombeve të Bashkuara, *Konventa e Këshillit të Evropës për masa kundër trafikimit të qenieve njerëzore*, *Direktiva e BE-së 2011/36/EU për parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të saj* dhe instrumente të tjera relevante evropiane dhe ndërkombëtare ligjore. Shqipëria ka ratifikuar Protokollin e OKB-së dhe Konventën e Këshillit të Evropës kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Dispozitat relevante mbi trafikimin dhe të drejtat e personave të trafikuar në nivel kombëtar janë përshkruar në aktet e mëposhtme:

- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë:
 - Neni 110a: Trafikimi i personave të rritur
 - Neni 128b: Trafikimi i të miturve
 - Neni 113: Prostitucioni
 - Neni 114: Shfrytëzimi i prostitucionit
 - Neni 115: Mbajtja e lokaleve për prostitucion
 - Neni 52a: Përfshirja ose ulja e dënimit për bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe viktimat

- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë
- Ligji Nr. 10039, 22 dhjetor 2008 “Për ndihmën juridike”
- Ligji Nr. 108/2013 “Për të huajt”
- Ligji Nr. 9887, 10 mars 2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”
- Ligji Nr. 10192, 3 dhjetor 2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”
- Ligji Nr. 10173, 22 tetor 2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”
- Ligji Nr. 9355, 10 mars 2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”
- Ligji Nr. 23/2012 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7895, 27 janar 1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”
- Ligji Nr. 144/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7895, 27 janar 1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”
- Rezoluta e Parlamentit Evropian, 26 shkurt 2014 për shfrytëzimin seksual, prostitucionin dhe ndikimin e tij në barazinë gjinore (2013/2103(INI))
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 582, 27 korrik 2011, “Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 195, 11 prill 2007 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në qendrat rezidenciale për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi”.

Veç këtyre, u përdorën dhe burimet e mëposhtme:

- Çështja e D.S., mbështetur me ndihmë ligjore falas nga avokatët e QNL;
- Çështja e B.Q., mbështetur me ndihmë ligjore falas nga avokatët e QNL;
- Vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për çështje me objekt shfrytëzimin e prostitucionit.
- Vendimet e Gjykatës së Krimeve të Rënda për çështje me objekt trafikimin e qenieve njerëzore.
- Intervistë me zv/drejtoreshën e Qendrës “Të ndryshëm dhe të barabartë”.

8

Elementët kyçë të projektit ishin trajnimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve për trafikimin e qenieve njerëzore, të organizuara nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare dhe Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me partnerët e tyre holandezë. Mendimet dhe opinionet që ndanë gjyqtarët dhe prokurorët gjatë këtyre trajnimeve janë reflektuar në këtë analizë ligjore.

Burime të tjera janë studimet dhe raportet mbi efektivitetin e legjislacionit lidhur me adresimin e trafikimit të qenieve njerëzore, të dhënat zyrtare të statistikave vjetore të përgatitura dhe publikuara nga Ministria e Drejtësisë dhe faqet e internetit të aktorëve të ndryshëm shtetërorë dhe joshtetërorë.

Së fundi, është përdorur praktika e QNL-së në dhënien e ndihmës ligjore falas për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore ose personave në rrezik trafikimi.

Mbështetja e ofruar nga ekspertja ndërkombëtare, znj. Marjan Wijers, ishte shumë e rëndësishme gjatë gjithë procesit të përgatitjes së kësaj analize.



PJESA 1

FAKTE DHE TË DHËNA

Çështjet e trafikimit të regjistruara nga gjykata janë të pakta, rreth 8-10 për vit. Shumica e tyre lidhet me trafikimin e brendshëm. Ky i fundit mbetet një shqetësim dhe numri i hetimeve pro-aktive duhet të rritet.¹

Megjithatë, nuk ka statistika të plota mbi trafikimin. Të dhënat e mëposhtme bazohen në statistikat vjetore kombëtare të Ministrisë së Drejtësisë² për periudhën 2011-2013.

Në vitin 2011 trafikimi u parashikua në tri dispozita të Kodit Penal (KP):³

- Neni 110a KP: Trafikimi i personave
- Neni 114b KP: Trafikimi i femrave
- Neni 128b KP: Trafikimi i të miturve

Për më tepër, neni 114 i KP kriminalizoi shfrytëzimin e prostitucionit, ndërsa neni 114a i KP parashikoi shfrytëzimin e prostitucionit në rrethana rënduese.⁴

Neni 110a i KP (Trafikimi i personave) parashikon:

1 Progres Raporti 2013 për Shqipërinë. Gjetet në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/albania_2013.pdf.

2 Të dhënat vjetore gjenden në adresën e Ministrisë së Drejtësisë: www.drejtesia.gov.al. Të dhënat vjetore 2011, faqja 36.

3 Trafikimi është parashikuar si dispozitë më vete prej vitit 2001.

4 Shtuar nga Ligji Nr. 8279, date 15 janar 1998, neni 2, pika 6 dhe paragrafi i fundit rregulluar nga Ligji Nr. 8733, date 24 janar 2001, neni 29.

10

Trafikimi i personave

Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga dy deri në pesë milionë lekë. Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të personave dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga katër deri në gjashtë milionë lekë.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga gjashtë deri në tetë milionë lekë.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm, si dhe me gjobë nga shtatë deri në dhjetë milionë lekë.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim dhe gjopa shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.

Neni 114/b i KP, (Trafikimi i femrave) parashikon:

1. *Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e femrave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike a psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve, për të marrë pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera*

- të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga tre deri në gjashtë milionë lekë.*
2. *Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të femrave dënohen me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga pesë deri në shtatë milionë lekë.*
 3. *Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarës për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga gjashtë deri në tetë milionë lekë.*
 4. *Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarës, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm, si dhe me gjobë nga shtatë deri në dhjetë milionë lekë.*
 5. *Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim dhe gjoba shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.*

Neni 128/b i KP (Ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004, neni 3; shtuar me ligjin nr. 9859, datë 21.1.2008, neni 3), Trafikimi i të miturve parashikon:

Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga katër deri në gjashtë milionë lekë.

Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të të miturve dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet dhe me gjobë nga gjashtë deri në tetë milionë lekë.

12

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike të të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga gjashtë deri në tetë milionë lekë.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm, si dhe me gjobë nga tetë deri në dhjetë milionë lekë.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim dhe gjoba shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.

Neni 114 i KP 2011 (Shfrytëzim i prostitucionit) parashikon:

Shtytja, ndërmjetësimi ose marrja shpërblim për ushtrimin e prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 114a i KP 2011 (shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese) parashikon:

Shfrytëzimi i prostitucionit i kryer:

1. *me të mitur;*
2. *ndaj disa personave;*
3. *me persona me të cilët ekzistojnë lidhje të afërta gjinie, krushqie, kujdestarie ose duke përfituar nga raportet zyrtare;*
4. *me mashtrim, shtrëngim, dhunë ose duke përfituar nga paaftësia fizike ose mendore e personit;*
5. *ndaj një personi që shtyhet ose shtrëngohet për të ushtruar prostitucion jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;*
6. *në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose nga persona të ngarkuar me funksione shtetërore dhe publike dënohet nga 7 deri në 15 vjet burgim.*

Neni 114b i KP 2011 (Trafikimi i femrave) parashikon:

Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e femrave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit,

shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike a psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve, për të marrë pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga tre deri në gjashtë milionë lekë.

Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të femrave dënohen me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga pesë deri në shtatë milionë lekë.

Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarës, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga gjashtë deri në tetë milionë lekë.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarës, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm, si dhe me gjobë nga shtatë deri në dhjetë milionë lekë.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim dhe gjoba shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.

Në vitin 2013, Kodi Penal u ndryshua (Ligji Nr. 144/2013 2 maj 2013). Që atëherë, trafikimi është parashikuar në dy dispozita:

- Neni 110a KP: Trafikimi i personave të rritur
- Neni 128b KP: Trafikimi i të miturve

Neni 114b i KP 2011 (Trafikimi i femrave) u shfuqizua dhe përbajtja e tij u përfshi në paragrafin 2 të nenit 110a të KP (trafikimi i personave). Në të njëjtin ligj, neni 114a i KP 2011 (shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese) u shfuqizua dhe përbajtja e tij u përfshi në nenin 114 të KP (Shfrytëzimi i prostitucionit). Dispozitat aktuale në Kodin Penal do të diskutohen në pjesën e dytë.

14

Të dhëna mbi këto vepra penale janë dhënë në vijim:

Të dhëna për veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore për vitin 2011

Vepra penale	Neni i KP 2011	Çështjet	Të dënuarit
Trafikimi i grave për prostitucion	114b (1)	1	1
Trafikimi i grave për prostitucion	114b (2)	2	3
Trafikimi i grave për prostitucion	114b (3)	6	9
Trafikimi i të miturve	128b (1)	1	1
Trafikimi i të miturve	128b (2)	2	4
Trafikimi i të miturve	128b (3)	1	1
Totali		13	19

Burimi: Ministria e Drejtësisë, Të dhënat vjetore 2011⁵

Të dhëna për veprat penale që lidhen me shfrytëzimin e qenieve njerëzore për vitin 2011

Vepra penale	Neni i KP 2011	Çështjet	Të dënuarit
Shfrytëzimi i prostitucionit	114	9	17
Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese	114a	6	5
Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese (kundrejt të miturve)	114a (1)	3	5
Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese (kundrejt disa personave)	114a (2)	2	2
Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese (me anë të përdorimit të forcës, mashtrimit, dhunës ose duke përfutur nga paaftësia fizike ose mendore e personit)	114a(4)	2	2
Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese (kundrejt një personi që është detyruar të ushtrojë prostitucion jashtë territorit të Shqipërisë)	114a(5)	2	2
Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese (nga një organizatë kriminale)	114a(6)	1	1
Totali		25	34

Burimi: Ministria e Drejtësisë, Të dhënat vjetore 2011⁶

5 www.drejtesia.gov.al, Ministria e Drejtësisë, Vjetari statistikor 2011, faqja 37.

6 www.drejtesia.gov.al, Ministria e Drejtësisë, Vjetari statistikor 2011, faqja 36,37.

Sipas të dhënave vjetore të Ministrisë së Drejtësisë, ka 27 dënime për shfrytëzim prostitucioni (neni 114 i KP 2011) për vitin 2011.

Të dhëna për veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore për vitin 2012

Vepra penale	Neni i KP 2011	Çështjet	Të dënuarit
Trafikimi i grave për prostitucion	114b (3)	2	2

Burimi: Ministria e Drejtësisë, Të dhënat vjetore 2012⁷

Sipas këtij burimi, për veprën penale të trafikimit të femrave për prostitucion, ka 2 persona të gjykuar. Njëri prej tyre është dënuar me 5-10 vite burg, ndërsa tjetri me 10-25 vite burg.

Të dhëna për veprat penale që lidhen me shfrytëzimin e qenieve njerëzore për vitin 2012

Vepra penale	Neni i KP 2011	Çështjet	Të dënuarit
Shfrytëzimi i prostitucionit	114	5	10
Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese	114a	9	9
Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese	114a (1)	2	2
Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese	114a (2)	2	6
Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese	114 a(3)	1	1
Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese	114/a (4)	2	3
Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese	114/a (5)	1	1
Totali		22	32

Burimi: Ministria e Drejtësisë, Të dhënat vjetore 2012⁸

Të dhëna për veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore për vitin 2013

Vepra penale	Neni i KP 2011	Çështjet	Të dënuarit
Trafikimi i grave për prostitucion	114b (3)	1	3
Trafikimi i të miturve	128b (1)	1	1
Totali		2	4

Burimi: Ministria e Drejtësisë, Të dhënat vjetore 2013⁹

7 www.drejtësia.gov.al, Ministria e Drejtësisë, Vjetari statistikor 2012, faqja 40.

8 www.drejtësia.gov.al, Ministria e Drejtësisë, Vjetari statistikor 2012, faqja 39.

9 www.drejtësia.gov.al, Ministria e Drejtësisë, Vjetari statistikor 2013, faqja 38-39.

16

Për veprën penale të trafikimit të grave për prostitucion ka tre persona të gjykuar. Dy prej tyre janë dënuar me 10-25 vite burg dhe i treti me burgim të përjetshëm.

Deri tani, çështjet e trafikimit me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit kanë qenë me viktime dhe trafikues shqiptarë. Shumica e grave dhe e vajzave vijnë nga zonat rurale.

Të dhëna për veprat penale që lidhen me shfrytëzimin e qenieve njerëzore për vitin 2013

Vepra penale	Neni i KP 2011	Çështjet	Të dënuarit
Shfrytëzimi i prostitucionit	114	8	6
Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese	114a	5	8
Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese (kundrejt të miturve)	114a (1)	2	1
Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese (kundrejt disa personave)	114a (2)	2	3
Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese (nga një organizatë kriminale)	114a(6)	2	2
Totali		19	20

Burimi: Ministria e Drejtësisë, Të dhënat vjetore 2013¹⁰

Edhe pse të dhënat nuk janë të ndara sipas gjinisë, sipas Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit për trafikimin e personave¹¹, Shqipëria është një burim dhe destinacion për burra, gra dhe fëmijë të trafikuar për shfrytëzim seksual ose punë të detyruar. Raporti i bën thirrje Gjykatës së Krimeve të Rënda t'i ndajë të dhënat për të treguar që bën përpjekje kundër të dyja formave.

Gjithashtu, edhe gratë dhe vajzat që kanë ushtruar prostitucion janë kriminalizuar sipas Kodit Penal (neni 113 CC).

Sipas të dhënave vjetore të vitit 2011, janë gjykuar 17 çështje penale me objekt "prostitucionin" dhe janë dënuar 27 persona.

10 www.drejtesia.gov.al, Ministria e Drejtësisë, Vjetari statistikor 2013, faqja 38.

11 http://www.punetebrendshme.gov.al/files/priorities_files/06202014_English_TIP.pdf.

Sipas të dhënave vjetore të vitit 2012, rezulton se janë gjykuar 16 çështje penale me objekt "prostitucionin" dhe janë dënuar 22 persona. Nga këta të fundit, 18 prej tyre janë femra.

Sipas të dhënave vjetore të vitit 2013 rezulton se janë gjykuar 9 çështje penale me objekt "prostitucionin" dhe janë dënuar 20 persona. Nga këta të fundit, 18 prej tyre janë femra.

Bazuar në nenin 113 të Kodit Penal, edhe vajzat e mitura mund të dënohen me burgim. Sipas të dhënave vjetore të vitit 2012¹², rezulton se dy të mitura janë dënuar për aktin e ushtrimit të prostitucionit. Sipas të dhënave vjetore të vitit 2013, rezulton se është dënuar një minorene për këtë vepër penale.¹³

12 http://www.drejtësia.gov.al/files/userfiles/statistika/VJETARI_STATISTIKOR_2012.pdf

13 http://www.drejtësia.gov.al/files/userfiles/statistika/VJETARI_STATISTIKOR_2013.pdf

II. PJESA 2

LEGJISLACIONI PENAL NË RSH DHE EVOLUIMI I TIJ

2.1. Trafikimi i qenieve njerëzore

Trafikimi i qenieve njerëzore është një krim kundër të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe dinjitetit të individit, kështu që masat e ndërmarra si parandaluese dhe mbrojtëse kanë synuar mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të viktimave, duke u kushtuar një vëmendje të veçantë.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është akti ligjor më i lartë, që sanksionon parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit si parim përshkrues i të gjithë legjislacionit. Neni 3 i Kushtetutës parashikon se “[...], dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij,[...]janë baza e këtij shteti, që ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë”.

Legjislacioni shqiptar është zhvilluar në përqasje me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Mekanizmi kushtetues shtron nevojën e përafritimit të legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare, me qëllim që ato të jenë pjesë e legjislacionit, që nuk mund të jetë në kundërshtim me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, në nivelin e Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian.

Normat ndërkombëtare kanë ndikim shumë të rëndësishëm në sistemin ligjor dhe politikat kombëtare të shtetit tonë. Kushtetuta (neni 5) parashikon se *“Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të”*.

Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara (neni 116) kanë fuqi mbi legjislacionin e brendshëm. Sipas nenit 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti ynë, pasi botohen në fletoren zyrtare, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik.

Shteti shqiptar është angazhuar në mënyrë të veçantë, për parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi i qenieve njerëzore, duke shprehur vullnetin e tij në luftën kundër këtij fenomeni edhe nëpërmjet ratifikimit të disa konventave¹⁴, që zënë një vend të veçantë në hierarkinë e akteve ligjore.

Shqipëria është shtet palë i Konventës së Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual.

Aktualisht Kodi Penal i RSH kriminalizon trafikimin e qenieve njerëzore në dy figura krimi: neni 110/a “Trafikimi i personave të rritur” dhe neni 128/b “Trafikimi i të miturve”. Kryerja e veprës penale të trafikimit ndaj një personi të rritur të gjinisë femërore parashikohet si rrethanë rënduese në paragrafin e 2-të të nenit 110/a.

-
- 14 Konventa ndërkombëtare për ndalimin e trafikut të grave dhe fëmijëve, përfunduar në Gjenevë, më 1921 dhe protokollin amendues i saj.
- Konventa për ndalimin e trafikut të grave në moshë madhore, përfunduar në Gjenevë më 1933 dhe protokollin amendues i saj.
 - Konventa për ndalimin e trafikut të personave dhe shfrytëzimit të prostitucionit të tjerëve dhe protokollin final i saj më 1950.
 - Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002.
 - Protokoll “Kundër trafikut të emigrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare” që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002.
 - Protokollin “Mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve”, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002.
 - Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave, CEDAW, 1979, ratifikuar me ligjin nr. 7767, datë 09.11.1993.
 - Konventa evropiane “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”, ratifikuar me ligjin nr. 9265, datë 29.07.2004.

20

Këto dispozita ndëshkojnë format dhe mënyrat e kryerjes së veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore për qëllime të shfrytëzimit të prostitucionit ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve si dhe formave të tjera të shfrytëzimit. Ndonëse "servitutet" nuk parashikohen si term specifik në tekstin e neneve të trafikimit (siç është parashikuar në përkufizimin e Protokollit të Kombeve të Bashkuara mbi trafikimin), kuptimi i servitutit përfshihet nga ligjvënësi shqiptar tek kuptimi i termit "forma të ngjashme me skllavërimin".

Lista e formave të shfrytëzimit nuk është shteruese. Kështu, është gjykata që vendos nëse një praktikë e caktuar bie në kuadrin e "shfrytëzimit" (p.sh. lypja e detyruar).

Neni 110/a i KP për trafikimin e personave të rritur parashikon:

1. *Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve, për të marrë pëlqimin e personit që kontrollojnë një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dënohen me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.*
2. *Kur kjo veprë kryhet ndaj një personi të rritur të gjinisë femërore dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.*
3. *Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të personave dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.*
4. *Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, sjell pasoja të rënda për shëndetin, ose rrezikon jetën e tij, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.*

5. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.
6. Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohet me $\frac{1}{4}$ e dënimit të dhënë.

Neni 128/b i KP për trafikimin e të miturve parashikon:

1. Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.
2. Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të të miturve dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.
3. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike të të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.
4. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.
5. Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohet me $\frac{1}{4}$ e dënimit të dhënë.

Me ndryshimet e kryera në bazë të ligjit nr. 144/2013 të veprës penale të trafikimit në ligjin nr. 144/213 është parashikuar kryerja e veprës penale të “trafikimit të personave të rritur” si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në lidhje me nenin 128/b të KP, në ndryshimet e fundit, është rritur masa e dënimit ndaj autorit të veprës penale, por kjo dispozitë nuk parashikon në mënyrë specifike nëse kjo vepër kryhet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Sipas

22

gjyqtarëve dhe prokurorëve¹⁵ është e nevojshme që neni 128/b i KP, “Trafikimi i të miturve”, të parashikojë të dyja rastet, kryerjen e veprës penale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në përputhje me Protokollin e OKB-së¹⁶ dhe Konventën e Këshillit të Evropës kundër trafikimit, neni 128/b i KP “Trafikimi i të miturve” nuk parashikon kryerjen e veprës nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike, ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër. Ky parashikim ka siguruar një mbrojtje të veçantë të një kategorie personash që janë tepër vulnerabël në shoqëri për shkak të pamundësisë së tyre për t’u mbrojtur dhe paaftësisë së tyre për të kuptuar rrezikun që u vjen nga këto veprime të paligjshme. Është shumë e rëndësishme që të gjithë profesionistët që punojnë për mbrojtjen e të miturve nga vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore të kuptojnë që pëlqimi është jorelevant, në rastin e të miturve dhe nuk ka nevojë të ketë mashtrim.

Shfrytëzimi i shërbimeve të personave të trafikuar dhe veprimet që lehtësojnë trafikimin

Në kuadrin e ndryshimeve të Kodit Penal me ligjin nr. 144/2013, është shtuar neni 110/b, që kriminalizon përfitimin apo përdorimin e shërbimeve të ofruara nga personat e trafikuar (neni 19 i Konventës evropiane) dhe neni 110/c, që kriminalizon veprimet që lehtësojnë trafikimin (neni 20 i Konventës evropiane).

Neni 110(b) i KP kriminalizon përfitimin apo përdorimin e shërbimeve të ofruara nga personat e trafikuar:

-
- 15 Ky mendim është shprehur nga gjyqtarët dhe prokurorët që morën pjesë në trajnimet e organizuara nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, Komitetin Holandez të Helsinkit dhe ekspertë nga Qendra e Trajnimeve dhe Studimeve për Gjyqësorin në Holandë, gjatë vitit 2013 dhe 2014.
- 16 Protokollin “Mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve”, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002.

1. Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruara nga personat e trafikuar, apo i shërbimeve që janë objekt i shfrytëzimit nga trafikimi, duke pasur dijeni që personi është i trafikuar, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.
2. Kur kjo vepër kryhet ndaj një fëmije dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Neni 110/c i KP, “Veprimet që lehtësojnë trafikimin” kriminalizon falsifikimin ose sigurimin e dokumenteve të identitetit ose udhëtimit kur ato shërbejnë për trafikimin e personave, edhe pa dijeninë e personit:

1. Falsifikimi, zotërimi ose sigurimi i dokumentit të identitetit, i pasaportave, i vizave ose i dokumenteve të tjera të udhëtimit apo mbajtja, heqja, fshehja, dëmtimi ose shkatërrimi i tyre, që kanë shërbyer për trafikimin e personave të rritur, por pa pasur dijeni për këtë fakt, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.
2. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, apo është kryer nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën, vizën apo dokumentin e udhëtimit, ose ka mundësuar trafikimin e fëmijëve, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.
3. Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet.

Nuk ka ende praktikë në lidhje me zbatimin e këtyre neneve.

Krahas nenit 110, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë ka parashikuar në nenin 189, “Falsifikimin e letërnjoftimeve, pasaportave ose të vizave”:

“Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën apo vizën, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet”

Duke konsideruar se të dyja këto vepra penale (neni 110/c , paragrafi i dytë dhe neni 189 i KP) kanë si element të përbashkët subjektin që kryen veprën penale dhe mënyrën e kryerjes së saj, zbatimi në praktikë i këtyre neneve mund të sjellë konfuzion në praktikë.

24

Trafikimi i të miturve dhe keqtrajtimi i tyre

Një tjetër përplasje ndodh midis nenit 128(b) "Trafikimi i të miturve" dhe nenit 124(b) KP "Keqtrajtimi i të miturve". Ky i fundit kriminalizon abuzimin me të miturit kur kjo veprë kryhet nga subjekte të veçanta si prindërit, kujdestari, gjyshërit, etj. Në mënyrë që të ofrohet një mbrojtje më e mirë për të miturit, neni 124(b) u ndryshua me Ligjin Nr. 144/2013.

Neni 124(b), paragrafi 1, parashikon:

Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor ose çdo person që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me burgim nga tre muaj gjer në dy vjet.

Më tej, Neni 124(b), paragrafi 2, parashikon:

Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik, apo arsimimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Kur nga vepra është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e të miturit, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet."

Megjithëse ligjvënësi në paragrafin e dytë të kësaj dispozite ka pasur për qëllim mbrojtjen e fëmijëve të mitur, ai ka disa elemente të përbashkëta me trafikimin e të miturve parashikuar nga neni 128/b i KP. Zbatimi i këtij neni në praktikë do të sillte konfuzion dhe nuk do të ishte në përputhje me interesin më të lartë të fëmijëve, të ndodhur në situata ligjore të tilla, të diskutueshme.

2.2. Puna e detyruar, skllavëria, praktika të ngjashme me skllavërinë dhe servituti

Kushtetuta ndalon të gjitha format e punës së detyruar (neni 26), ndërsa Kodi Penal nuk ka dispozita të veçanta për kriminalizimin e punës së detyruar ose të skllavërisë. Por, puna e detyruar dhe skllavëria janë elementë të veprës penale

të trafikimit të personave të rritur dhe trafikimit të të miturve. Ka një praktikë të kufizuar mbi punën e detyruar dhe skllavërinë¹⁷, kështu që nuk është ende e qartë se si interpretohen këto koncepte në praktikën juridike. Megjithatë, ato janë të përkufizuara tek E Drejta ndërkombëtare, veçanërisht tek konventat e ILO mbi punën e detyruar. Gjithashtu, praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut jep udhëzime në rastet *Siliadin v. France* (nr. aplikimi 73316/01) dhe *C.N. dhe V. v. France* (nr. aplikimi. 67724/09).¹⁸

2.3. Prostitucioni

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë kriminalizon shfrytëzimin e prostitucionit, mbajtjen e lokaleve për prostitucion dhe vetë ushtrimin e prostitucionit.

Shfrytëzimi i prostitucionit kriminalizohet në nenin 114 të KP:

1. *Shtytja, ndërmjetësimi ose marrja shpërblim për ushtrimin e prostitucionit dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.*
2. *Po kjo vepër, kur kryhet me të mitur, ndaj disa personave, me persona me të cilët ekzistojnë lidhje të afërta gjinie, krushqie, kujdestarie, apo duke përfutur nga raportet zyrtare, ose kryhet në bashkëpunim apo më shumë se një herë, ose nga persona të ngarkuar me funksione shtetërore dhe publike, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.*

Neni 115 i Kodit Penal kriminalizon **mbajtjen e lokaleve për prostitucion duke parashikuar:**

“Mbajtja, shfrytëzimi, financimi, dhënia me qira e lokaleve për ushtrim të prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjër në dhjetë vjet.”

17 Qendra për Nisma Ligjore Qytetare nuk ka mbështetur raste të viktimave të punës së detyruar ose skllavërisë.

18 *Praktika kyçe të GJEDNJ, Ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar, Neni 4 i Konventës. Guida mbi nenin 4, dhjetor 2012: http://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_4_ENG.pdf; GJEDNJ – Trafikimi i qenieve njerëzore, mars 2014: http://www.echr.coe.int/Documents/FS_Trafficking_ENG.PDF; GJEDNJ – Skllavëria, servituti dhe puna e detyruar, mars 2014: http://www.echr.coe.int/Documents/FS_Forced_labour_ENG.pdf.*

26

Dallimi midis veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore dhe veprës penale të shfrytëzimit të prostitucionit

Formalisht, dallimi ndërmjet veprave penale të shfrytëzimit të prostitucionit (neni 114 KP) dhe trafikimit të qenieve njerëzore për qëllime prostitucioni (neni 110(a) dhe 128(b) KP) është i qartë dhe qëndron në mënyrën dhe format e realizimit të secilës prej tyre. Sipas Kodit Penal, shfrytëzimi i prostitucionit kryhet përmes shtytjes, ndërmjetësimit ose marrjes shpërblim për ushtrimin e prostitucionit, ndërsa trafikimi, përveç këtyre elementeve, kërkon gjithashtu elemente të tjerë, si rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave përmes përdorimit të detyrimit ose forcës. Megjithatë, në praktikë ka shpesh konfuzion për ndryshimet midis trafikimit dhe shfrytëzimit të prostitucionit, veçanërisht në gjykatat e rretheve gjyqësore. Kjo është e rëndësishme sepse ato vendosin nëse çështja duhet t'i referohet Gjykatës së Krimeve të Rënda.

Këto dy vepra përfshihen në seksione të ndryshme në Kodin Penal. Trafikimi i personave të rritur (neni 110(a) i KP) përfshihet në kapitullin e veprave penale kundër lirisë së personit, ndërsa shfrytëzimi i prostitucionit (neni 114 i KP) përfshihet në kapitullin e veprave penale kundër moralit dhe dinjitetit.

Sipas mendimit të dy gjyqtarëve të Gjykatës për Krime të Rënda në Tiranë, veprat penale të shfrytëzimit të prostitucionit dhe trafikimit të personave të rritur ndryshojnë nga njëra-tjetra nga mënyra se si ato kryhen dhe çfarë ato mbrojnë në raport me personat e dëmtuar¹⁹. Nenet e trafikimit parashikojnë vepra penale që lidhen me mbrojtjen e lirisë dhe dinjitetit të personit si një e drejtë themelore, ndërsa neni 114 i KP "Shfrytëzimi i prostitucionit" mbron moralin dhe dinjitetin e personit.

Sipas një tjetër gjyqtari, dallimi midis veprave të trafikimit dhe shfrytëzimit të prostitucionit qëndron në faktin se në veprat penale të trafikimit viktimat është tërësisht e kontrolluar nga subjekti i veprës penale dhe kryen çdo veprim që i kërkohet prej tij. Është një varësi e plotë e viktimës ndaj personave, autorë të veprës penale, për shkak të kërcënimit, dhunës, mashtrimit, shkatërrimit të personalitetit etj, në mungesë të plotë të vullnetit të viktimës në kryerjen e veprimeve të prostituimit.

19 Intervistë e datës 26 maj 2014.

Rrjedhimisht, ngrihet pyetja nëse ligji mbron edhe prostitutat nga trafikimi dhe detyrimi për të punuar ose nëse pëlqimi për prostitucion konsiderohet si miratim për dhunë dhe abuzim. Kjo nënkupton që prostitutat mund të trafikohen pa ndëshkim. Një arsyetim i ngjashëm në lidhje me trafikimin do të ishte p.sh. puna në shtëpi do të nënkuptonte që, nëse një person pranon të punojë në një shtëpi dhe vazhdon ende të pranojë, do të përjashtojë njohja e tij si viktimë trafikimi për punë shtëpie. Kjo pyetje nuk ka vetëm rëndësi teorike, por mund të ketë edhe pasoja shumë të rënda për personin. Viktima do të përfitojë mbrojtje dhe asistencë ose do të procedohet dhe ndëshkohet, në varësi të kualifikimit të veprës si trafikim apo si shfrytëzim prostitucioni.

Rëndësia lidhet jo vetëm me kualifikimin e duhur të veprës penale, por gjithashtu me faktin se dy veprat penale janë në kompetencë të gjykatave të ndryshme. Kështu, nenet 110/a, 128/b të KP janë në kompetencë të Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe neni 114 i KP është në kompetencë të gjykatave të rretheve gjyqësore.

Të miturit

Veçanërisht përplasja midis nenit 114(2), shfrytëzimi i të miturve për prostitucion dhe nenit 128(b), trafikimi i të miturve për prostitucion shkakton probleme në praktikë, duke qenë se ky i fundit kriminalizon çdo shfrytëzim të fëmijëve, pavarësisht vullnetit të tyre apo mjeteve të mashtrimit. Kjo është në përputhje me Protokollin e OKB-së dhe Konventës së KE-së mbi trafikimin, si edhe me Konventën mbi format më të këqija të shfrytëzimit të fëmijëve për punë, e cila përkufizon çdo përdorim apo ofrim të fëmijës për prostitucion si shfrytëzim (neni 3).

Sipas opinionit të një prokurori në zyrën e Prokurorisë të Krimeve të Rënda në Tiranë, përplasja midis tyre shkakton debat për kualifikimin e veprave:

“Dallimi [ndërmjet trafikimit dhe shfrytëzimit të prostitucionit] konsiston në mënyrën dhe formën e kryerjes së secilit prej tyre. Megjithatë, nuk është e qartë cila është diferenca ndërmjet paragrafit të dytë të nenit 114 të KP, lidhur me shfrytëzimin e të miturve për prostitucion dhe veprës së trafikimit të të miturve, sipas përkufizimit të trafikimit në Konventën e Këshillit të Evropës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, që pavarësisht nga vullneti i fëmijës, shfrytëzimi i tyre do të konsiderohet trafikim. Në

praktikë, kjo situatë ka shkaktuar probleme në lidhje me kualifikimin e veprës penale” (intervistë, 26 maj 2014).

Kriminalizimi i prostitutave dhe klientëve

Prostitutat mund të ndiqen penalisht në bazë të nenit 113(1) KP, që dënon ushtrimin e prostitucionit. Dënimi maksimal është 3 vite burgim, por në praktikë shpesh jepet 1 vit me kusht. Personat që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç nuk mund të procedohen penalisht (neni 12 KP).

Në të shkuarën legjislacioni penal penalizonte vetëm prostitutat. Me ligjin nr. 23/2012²⁰, përmbajtja e nenit 113 të KP ndryshoi si vijon duke ndëshkuar edhe klientët:

3. *Ushtrimi i prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.*
4. *Dhënia e shpërblimit për përfitim personal të prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.*

Më parë, dëshmia e klientëve ishte prova më e rëndësishme, por kjo tashmë ka ndryshuar.

Sfondi i ndryshimeve në Kodin Penal lidhur me nenin 113 të KP

Hapat ligjorë me qëllim shfuqizimin e nenit 113 të Kodit Penal, si antikushitetues u iniciuan nga QNL, përmes paraqitjes së një informacioni pranë komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe ofrimit të ndihmës ligjore falas për çështjen B.Q, e akuzuar dhe dënuar nga gjykatat për veprën penale të prostitucionit, bazuar në nenin 113 të KP. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, në informacionin e datës 11 janar 2012, i ka kërkuar komisionerit të ushtrisë kompetencat ligjore bazuar në ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe tu rekomandojë autoriteteve përgjegjëse të shfuqizojnë nenin 113 të KP, si një nen që cenon parimin e barazisë gjinore, përmes diskriminimit të tërthortë gjinor mbi gratë dhe vajzat.

20 Ligji nr. 23/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, me rekomandimin nr. 49, datë 13.2.2012, e adresoi këtë çështje pranë komisionit për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe kryetarja e Kuvendit rekomandoi shfuqizimin e nenit 113 të KP, me qëllim që prostitutat të mos bëhen subjekte të ndjekjes penale dhe ndëshkimit.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë nuk e shfuqizoi nenin 113 të KP "Prostitucioni", por ky nen pësoi ndryshime duke shtuar paragrafin e dytë. Përmbajtja e nenit 113 të KP, me ligjin nr. 23/2012²¹, ndëshkon edhe klientët.

Ky ndryshim ligjor nuk e përmirësoi situatën ligjore të prostitutave. Neni në fjalë vazhdon të ketë efekte negative mbi gratë.

Nëse i referohemi raportit, "Njohja dhe zbatimi i standardeve të barazisë gjinore në procesin gjyqësor"²², mbi gjetjet kryesore nga monitorimi i vendimeve të gjykatave të shkallës I, të rretheve gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër e Vlorë, për periudhën 1 janar 2011 - 1 qershor 2012, rezulton se për prostitucion janë dënuar vetëm gratë. Gjithashtu dhe të miturit procedohen dhe dënohen për prostitucion.

Më 2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka dhënë gjithsej 15 vendime dhe ka dënuar për këtë vepër penale 17 gra. Për vitin 2012 ka rezultuar nga monitorimi se janë dhënë gjithsej 12 vendime dhe janë dënuar 13 femra; 10% e 30 grave dhe vajzave të dënuara në vitet 2011-2012 janë të mitura, 20 % e tyre i përkasin grup-moshës 18-20 vjeç, 43.3% e tyre i përkasin grup-moshës 21-30 vjeç, më shumë se 63% e tyre janë pa arsim ose deri në 8 klasë, ndërsa rreth 13 % e tyre janë me arsim të mesëm. Në rreth 23 % të rasteve nuk ka të dhëna në lidhje me gratë e dënuara për prostitucion. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës për vitin 2011 ka dhënë vetëm një vendim, përmes të cilit është dënuar një femër për këtë vepër dhe për vitin 2012 kemi 5 vendime penale, të cilat kanë dënuar 4 femra dhe vetëm 1 prej tyre është mashkull.

Për të kuptuar efektet e ndryshimit të nenit 113 KP, QNL monitoroi edhe vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2013.

21 Ligji nr. 23/2012, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Fletorja zyrtare nr. 26, faqe 1299.

22 QNL, "Njohja dhe zbatimi i standardeve të barazisë gjinore në procesin gjyqësor", në faqen web të QNL www.qag-al.org.

30

Në vitin 2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka dënua 5 gra dhe 2 burra në bazë të nenit 113/1 të Kodit Penal, i ndryshuar. Ka rezultuar nga arsyetimi i vendimeve gjyqësore nga gjyqtarët se të gjitha gratë e dënuara janë nga familje me probleme socialekonomike. Kështu, personat që ushtrojnë prostitucionin janë në mënyrë të veçantë vulnerabile në aspektin ekonomik, fizik, psikologjik, emocional, në lidhje me kushtet familjare dhe janë më shumë në rrezik për t'u përballur me dhunë dhe dëmtime.

Kështu, pavarësisht se neni 113 i KP, (i ndryshuar) në dukje është neutral nga perspektiva gjinore, ai sjell efekte negative dhe diskriminuese mbi gratë, për shkak se janë gra dhe për shkak të vulnerabilitetit të tyre. Kjo situatë reflekton faktin se legjislacioni penal në lidhje me prostitucionin vazhdon të mos jetë në përputhje me nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare.

Në lidhje me të miturit, neni shkel veçanërisht Konventën e ILO mbi format më të këqija të shfrytëzimit të fëmijëve për punë²³, e cila përkufizon “përdorimin ose ofrimin e të miturit për prostitucion, për prodhimin e pornografisë ose për performanca pornografike” si një nga format më të këqija të shfrytëzimit për punë të të miturit dhe detyron shtetet anëtare të japin asistencën e nevojshme për ta larguar të miturin nga kjo gjendje dhe për ta rehabilituar atë; të sigurojnë akses në edukimin falas dhe, ku është e mundur dhe e përshtatshme, trajnime profesionale për fëmijët e larguar nga shfrytëzimi për punë, veçanërisht duke mbajtur parasysh pozitën e veçantë të vajzave (neni 7).

Për më tepër, neni 113 i KP (i ndryshuar) është në kundërshtim me Konventën e OKB-së mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, e ratifikuar nga Shqipëria më 1993. Ai bie në kundërshtim edhe me rezolutën e 26 shkurtit 2014 të Parlamentit Evropian, “Shfrytëzimi seksual dhe prostitucioni dhe ndikimi i tyre mbi barazinë gjinore” (2013/2103(INI)), që tërheq vëmendjen se blerja e shërbimeve seksuale nga prostitutat nën moshën 21 vjeç duhet të jetë një vepër penale, ndërsa ofrimi i shërbimeve të tilla nga prostitutat nuk duhet të dënohet (pika 19). Në pikën 26, rezoluta u bën thirrje shteteve anëtare për shfuqizimin e legjislacionit ndëshkues ndaj personave që ushtrojnë prostitucion.

23 Ratifikuar nga Shqipëria në 2 gusht 2001.

Një qëndrim i tillë është mbajtur edhe nga doktrina shqiptare, e cila në interpretimin e këtij neni shprehet për nevojën e shfuqizimit të tij²⁴.

Çështja B.Q.

Një nga çështjet e mbështetura nga QNL, është rasti i një vajze, e cila u akuzua dhe u dënua për ushtrim prostitucioni. Në maj të vitit 2011, B.Q. është deklaruar fajtores dhe është dënua nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me anë të vendimit nr. 744, datë 06.05.2011, për kryerjen e veprës penale të prostitucionit në bazë të nenit 113 të Kodit Penal të RSH. Dënimi u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë (vendimi nr. 1430, datë 21.12.2011).

Avokatët kanë kërkuar përpara dy gjykatave deklarimin e pafajshme të B. Q., me pretendimin se neni 113 i Kodit Penal vjen në kundërshtim me nenin 18²⁵ të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Konventës mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, CEDAW²⁶. Në zbatim të nenit 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është kërkuar pezullimi i gjykimit dhe dërgimi i çështjes për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, kërkesë e cila nuk u mor parasysh nga të dyja gjykatat.

B.Q., e mbështetur nga avokatët e QNL-së, paraqiti rekurs në Gjykatën e Lartë duke kërkuar pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes për gjykim në Gjykatën Kushtetuese, me qëllim shfuqizimin e nenit 113 të Kodit Penal, i ndryshuar, i cili vjen në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, CEDAW.

Në këtë proces gjyqësor në Gjykatën e Lartë u argumentua se Komiteti CEDAW, duke marrë në konsideratë dy raportet e para periodike të shtetit shqiptar në vërejtjet përfundimtare, më 2003 ka shprehur qartë shqetësimin se “janë

24 Ismet Elezi, “E Drejta penale: Pjesa e posaçme”, Tirana 2009.

25 Neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë:

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

26 E vlefshme në: <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/cedaw.htm>

prostitutat ato që ndiqen penalisht dhe dënohen dhe jo ata që i shfrytëzojnë” A/58/38 (Supp), para.70). Në vërejtjet përfundimtare të 30 korrikut 2010, Komiteti përsëriti shqetësimin që prostitutat dhe viktimat e trafikimit mbeten subjekte të ndëshkimit në Kodin Penal, duke theksuar se “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë është një ndër të paktit, në mos i vetmi në Evropë, që ndëshkon prostitutat” (CEDAW/C/ALB/Q/3, para. 13²⁷). Ai nxit shtetin shqiptar:

“të ndryshojë Kodin e tij Penal në mënyrë që prostitutat të mos ndiqen dhe dënohen penalisht dhe të sigurojë programe të përshtatshme mbështetjeje për gratë që dëshirojnë të largohen nga prostitucioni” (CEDAW/C/ALB/CO/3, para. 29²⁸).

Avokatët e QNL-së, para Gjykatës së Lartë përdorën si mjet Konventën CEDAW, bazuar në faktin se kjo Konventë referuar nenit 116 dhe 122 të Kushtetutës, ka epërsi mbi ligjet e brendshme të vendit. Gjithashtu, u argumentua para Gjykatës së Lartë se Komiteti i CEDAW-t është organi kompetent që mund të bëjë interpretimin përfundimtar të Konventës së CEDAW-t.

QNL i kërkoi Gjykatës së Lartë që në dhënien e vendimit përfundimtar në lidhje me çështjen B.Q të konsiderojë politikat e BE, të cilat shkojnë drejt ndalimit të masave shtrënguese për personat që prostitutojnë dhe rekomandojnë ndalimin e blerjes së aktit seksual. U soll në vëmendje të Gjykatës së Lartë, Rezoluta e 26 shkurtit 2014 e Parlamentit Evropian, “Shfrytëzimi seksual dhe prostitucioni dhe ndikimi i tyre mbi barazinë gjinore” (2013/2103(INI)), e cila thekson se prostitucioni i detyruar mund të ketë pasoja fizike dhe psikologjike shkatërruese dhe të gjata për individët e përfshirë (edhe pasi ta kenë lënë prostitucionin), veçanërisht për fëmijët dhe adoleshentët. U përmend se rezoluta u kërkon shteteve të konsiderojnë modelin e zbatuar në Suedi, Islandë dhe Norvegji (i ashtuquajtur i modeli nordik), si një mënyrë të mundshme për të luftuar trafikimin e grave dhe vajzave për shfrytëzim seksual dhe për të përmirësuar situatën e barazisë gjinore. Ky model po konsiderohet në një sërë vendesh evropiane dhe dënon blerjen e shërbimeve seksuale dhe jo shërbimin e ofruar nga personat e prostituar.

27 E vlefshme në: <http://www2.ohchr.org/english/bodies/cedaw/docs/AdvanceVersions/CEDAW-C-ALB-Q3.pdf>. Shih gjithashtu, përgjigjet e Listës së çështjeve dhe pyetjeve, par 57 dhe 58, e vlefshme në: <http://www.refworld.org/pdfid/4eeb28c12.pdf>.

28 <http://www2.ohchr.org/english/bodies/cedaw/docs/co/CEDAW-C-ALB-CO-3.pdf>.

Në përfundim, Gjykata e Lartë, pasi shqyrtoi çështjen në datën 02.04.2014 vendosi të pranojë kërkesën dhe ta dërgojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese për të kontrolluar kushtetutshmërinë e nenit 113 të K.P.

Kompetenca e Gjykatës së Krimeve të Rënda

Ligji nr. 9110, datë 24.07.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda” ka vendosur kompetencën e Gjykatës së Krimeve të Rënda për të shqyrtuar të gjitha çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore. Kjo gjë ka rritur efektivitetin e luftës kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda. Gjykimi i çështjeve të trafikimit të qenieve njerëzore vetëm nga kjo gjykatë ka sjellë unifikimin e praktikave gjyqësore në lidhje me çështje të trafikimit të qenieve njerëzore.

Sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale (KPP), “Kompetencat e Gjykatës për Krime të Rënda”, i ndryshuar, Gjykata e Krimeve të Rënda ka kompetencën materiale dhe territoriale të gjykojë çështjet në lidhje me nenin 110/a, “Trafikimi i personave të rritur” dhe nenin 128/b, “Trafikimi i të miturve”. Çështjet mbi shfrytëzimin e prostitucionit dhe kalimin e paligjshëm të kufirit gjykohe nga gjykatat e zakonshme të rretheve gjyqësore.

2.4. Të dhënat mbi praktikën gjyqësore dhe publikimi i tyre

Nuk ka një data-bazë qendror mbi jurisprudencën gjyqësore. Vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka një website të mirë në të cilin publikohen vendimet. Gjykatat e rretheve të tjera gjyqësore nuk i publikojnë rregullisht vendimet e tyre.

Institucione të ndryshme janë përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave mbi fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore. Ministria e Brendshme është autoriteti përgjegjës administrativ për trafikimin e qenieve njerëzore.

Strukturat kryesore që punojnë për adresimin e fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore janë: Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Gjykata e Shkallës së parë për Krime të Rënda, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (ish Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta); Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Punëve të Jashtme; Qendra

34

Kombëtare për Pritjen e Viktimave të Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Shkolla e Magjistraturës, e cila organizon trajnime për profesionistët e sistemit gjyqësor.

Koordinatorja kombëtare për trafikimin e qenieve njerëzore dhe Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet Vjetarit statistikor janë instancat kryesore për mbledhjen e të dhënave dhe jurisprudencën. Botimet e USAID, OSCE/ODIHR dhe Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare janë burime të tjera për të mbledhur dhe sistemuar çështjet strategjike dhe jurisprudencën.

Vjetarët statistikorë të Ministrisë së Drejtësisë janë të vlefshëm për publikun në websitin e Ministrisë së Drejtësisë, por ata nuk përmbajnë të dhëna të vitit të fundit. Janë bërë përpjekje për publikimin dhe unifikimin e jurisprudencës kryesisht nga organizata ndërkombëtare dhe kombëtare në Shqipëri.

Gjatë viteve të fundit, vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut janë botuar në websitin e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare. Materiale në lidhje me adresimin e trafikimit të qenieve njerëzore janë përdorur në trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës për gjyqtarët, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore, stafin e Shkollës së Magjistraturës etj. Të dhëna në lidhje me numrin e profesionistëve të sistemit të drejtësisë të trajnuar në lidhje me çështjen e trafikimit të qenieve njerëzore janë të vlefshme në websitin e Shkollës së Magjistraturës. Kështu, referuar në këtë websit, për vitin akademik 2013-2014, janë trajnuar 74 pjesëmarrës në lidhje me çështjen e trafikimit të qenieve njerëzore, 238 pjesëmarrës në lidhje me ndryshimet e vitit 2012 dhe 2013 në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë dhe 92 pjesëmarrës në lidhje me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut.

Mbledhja e të dhënave është shumë e rëndësishme, veçanërisht për të ndërtuar politikat dhe ndërhyrjet në lidhje me adresimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Ato tregojnë tendencën e këtij fenomeni dhe përcaktojnë mënyrat e adresimit të tij nga shoqëria.



PJESA 3

POZITA E PËRGGJITHSHME E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE NË PROCESIN PENAL

Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore janë dëshmitarë në procesin penal kundër autorit të veprës penale. Në rastet kur ato gjithashtu ushtrojnë të drejtën për të kërkuar kompensim për dëmet e pësuar nga autori i veprës duke paraqitur një padi civile në procesin penal sipas nenit 62 të Kodit të Procedurës Penale (prej këtu e në vijim KPP), ato janë palë e dëmtuar. Nuk ka dispozita të veçanta në KPP mbi statusin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore; pozita e tyre është e barabartë me dëshmitarët ose palët e dëmtuara.

Të gjitha çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore gjykohen nga Gjykata e Krimeve të Rënda, e cila ka kompetencën materiale dhe territoriale për të gjykuar çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore. Çështjet me objekt shfrytëzimin e prostitucionit dhe kalimin e paligjshëm të kufirit gjykohen nga gjykatat e zakonshme të rretheve gjyqësore.

Ka një numër dispozitash të KPP që sigurojnë mbrojtje për viktimat, përfshirë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

36

- Dëshmitarët mund të pyeten në distancë, brenda ose jashtë vendit, përmes lidhjes audio-vizive.
- Kur ka baza të arsyeshme për të menduar se personi mund të jetë subjekt i dhunës ose kërcënimit, dëshmia e viktimës gjatë hetimit paraprak mund të pranohet si provë gjatë gjykimit.
- Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krimeve të rënda” siguron që dëshmitarët të mund të pyeten në prani të të pandehurit dhe të pandehurve, por pa kontakt vizual dhe pa i komunikuar të pandehurit identitetin e viktimës.
- Pyetja e dëshmitarëve të mitur mund të kryhet nga gjyqtari kryesues, bazuar në kërkesat dhe kundërshtimet e palëve. Gjyqtari kryesues mund të asistohet nga një anëtar i familjes së të miturit ose nga një specialist i fushës së edukimit të fëmijëve.

Sipas KPP, zyra e prokurorisë mund të nisë ndjekjen penale në vijim të denoncimit të qytetarit ose *ex officio*. Në praktikë, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore raportojnë krimin në polici ose në prokurori. Në shumë raste, denoncimi penal është bërë nga të afërm të viktimës. Denoncimet penale vlerësohen me seriozitet dhe pas regjistrimit të rastit merren masa me qëllim ofrimin e asistencës së nevojshme për viktimën dhe mbledhjen e provave, me qëllim vënien e autorëve të veprës para drejtësisë. Për këtë qëllim mund të aplikohen teknika të veçanta hetimi. Prej vitit 2010 është krijuar një skuadër e veçantë për hetimin e çështjeve të trafikimit të qenieve njerëzore në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Kjo skuadër përbëhet nga tre prokurorë dhe katër oficerë të policisë gjyqësore. Puna e kësaj skuadre koordinohet me punën e seksioneve mbi trafikimin në drejtoritë rajonale të policisë si edhe me zyrën e koordinatores së njesisë antitrafikim në Ministrinë e Brendshme.

Problemet kryesore

Është detyrim i shtetit shqiptar dhe nevojë e domosdoshme, që rrjedh nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara, garantimi i mbrojtjes ligjore me avokat falas për viktimat e trafikimit që nga kontakti i parë i tyre me organet e policisë, në organet e hetimit, proceset gjyqësore penale e civile dhe në çdo proces administrativ ku viktima ballafaqohet.

KPP i Republikës së Shqipërisë nuk u garanton viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore mbrojtje ligjore me avokat në proceset penale, nuk e legjitimon viktimën e trafikimit si palë në procesin hetimor dhe gjyqësor. Viktima e trafikimit të qenieve njerëzore ka statusin e dëshmitares në procesin penal ndaj autorit të veprës penale dhe në këto kushte nuk ka të drejtë të mbrohet me avokat. Në rastet kur viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore ushtrojnë të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim nga autori i veprës penale me padi civile në procesin penal, ato kanë të drejtë të përfaqësohen me avokat.

Në vitin 2013 ligji për ndihmën juridike u ndryshua, duke u dhënë të drejtën për ndihmë ligjore falas viktimave të trafikimit. Megjithatë, ka pengesa serioze në zbatimin e këtij ligji. Pavarësisht këtij ndryshimi, deri tani ndihma dhe përfaqësimi ligjor bëhet kryesisht nga OJF-të si Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Qendra psikosociale “Vatra” etj.

Procedurat e tejzgjatura të proceseve gjyqësore dekurajojnë viktimën në lidhje me kërkimin dhe gëzimin e kësaj të drejte. Tejzgjatja e procedurave e vë në rrezik jetën e viktimës nga autorët e këtyre veprave penale.

Legjislacioni shqiptar parashikon mundësinë për kompensimin e viktimave nga autori i veprës penale përmes dy procedurave: së pari nëpërmjet padisë civile në procesin penal për kërkimin e dëmit material, bazuar në nenin 62 të Kodit të Procedurave Penale dhe së dyti nëpërmjet kërkimit të dëmit material dhe moral në një proces civil bazuar në nenin 608 dhe 625 të Kodit Civil.

Në bazë të KPP, gjykata penale është e lejuar që të veçojë padinë civile nga procesi penal dhe ta dërgojë atë për gjykim në procesin civil. Kjo mund të ndodhë jo vetëm me kërkesë të palëve, por edhe *ex officio*, nëse gjykimi i padisë civile vështirëson ose zvarrit procesin penal²⁹. Në praktikë kjo gjë ndodhë zakonisht. Megjithatë, kërkimi i kompensimit në një procedurë civile është i kushtueshëm dhe kërkon shumë kohë dhe në këtë mënyrë nuk përbën një mjet real dhe efektiv për viktimat e trafikimit për të përfituar dëmshpërblim.

Për më tepër, nuk është e mundur të kërkosh dëmshpërblim moral në një proces penal. Në bazë të nenit 61 të KPP të Republikës së Shqipërisë, paditësi civil në

29 Shtojcë Kodit të Procedurës Penale sipas Ligjit nr. 8813, datë 13.06.2002.

38

procesin penal, në pozitën e të cilit mund të jetë viktimja e trafikimit të qenieve njerëzore, ka të drejtën e kërkimit vetëm të dëmit material³⁰. Fakti që dëmet morale nuk janë të kërkueshme në procesin penal, përfaqëson një pengesë serioze për dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit, duke pasur parasysh se në rastin e viktimave të kësaj veprë penale dëmi material shoqërohet domosdoshmërisht me dëmin moral.

Si përfundim, edhe pse mund të akordohet dëmshpërblim në një proces civil apo penal, ekzekutimi i urdhrat të kompensimit përbën një pengesë të pakalueshme. QNL nuk ka informacion për raste, në të cilat kompensimi është dhënë *de facto* për viktimën.

Për sa më sipër, shtrohet nevoja për ndryshime urgjente në Kodin e Procedurës Penale, me synimin e lehtësimit të procedurave për gjykimin e padisë civile në procesin penal për të kërkuar dëmshpërblimin material dhe moral nga autori i veprës penale në rrugë gjyqësore.

Gjithashtu, përfshirja e dispozitave të veçanta dhe specifike në Kodin Civil në lidhje me dëmshpërblimin për dëmin e pësuar nga shfrytëzimi seksual, shfrytëzimi për punë, shërbime të detyruara ose forma të tjera të shfrytëzimit që përbëjnë elementë të veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore, do të krijonte më shumë mundësi për garantimin në praktikë të së drejtës për dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit.

Pozicioni i viktimave të mitur (nën 18 vjeç) në procesin penal

Ka një mungesë të garancive procedurale për marrjen në pyetje të të miturve gjatë fazës së hetimeve paraprake. Marrja në pyetje nga ana e gjykatës rregullohet në nenin 361(5) të KPP, që parashikon:

Pyetja e dëshmitarëve të mitur mund të bëhet nga kryetari, mbi kërkesat dhe kundërshtimet e palëve. Kryetari mund të ndihmohet nga një familjar i të miturit ose nga një specialist i fushës së edukimit të fëmijëve. Kur çmohet se pyetja e

30 Neni 61 i Kodit të Procedurës Penale parashikon edhe të drejtën e trashëgimtarëve të viktimës për të kërkuar me padi civile në procesin penal kthimin e pasurisë ose shpërblimin e dëmit nga autori i veprës penale.

drejtpërdrejtë e të miturit nuk e dëmton gjendjen psikologjike të tij, kryetari urdhëron që pyetja të vazhdojë sipas dispozitave të paragrafëve 1 dhe 2. Urdhri mund të revokohet gjatë pyetjes.

Megjithatë, Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon garanci procedurale për viktimat e mitura, kur ato merren në pyetje nga policia ose prokurori gjatë fazës së hetimit paraprak, duke qenë se nuk detyron marrjen në pyetje në prezencën e një psikologu, punonjësi social apo të afërmi. Në praktikë psikologët ose punonjësit socialë marrin pjesë në intervistat me të mitur.

Pavarësisht mungesës së garancive procedurale, Kodi i Procedurës Penale parashikon mekanizma që mund të mbrojnë viktimat e trafikimit: Dëshmitari mund të pyetet në distancë, brenda ose jashtë vendit, me anë të lidhjes audiovizive; dëshmitarët e mitur mund të merren në pyetje nga një gjyqtar i specializuar në varësi të çështjes; Kryetari mund të ndihmohet nga një familjar i të miturit ose nga një specialist i fushës së edukimit të fëmijëve. Nëse ka arsye për të besuar që viktimat/dëshmitari është në rrezik ose kërcënim, dëshmia mund të sigurohet gjatë hetimeve paraprake. Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krimet e rënda” parashikon se dëshmitarët mund të pyeten në praninë e të pandehurit dhe avokatit të tij, por pa kontakt vizual dhe pa ua bërë të ditur atyre identitetin e viktimës.

Përkufizimi i termit “viktimë”

Ligji nuk jep përkufizimin e termit “viktimë”. Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, përdoret termi “person i trafikuar” ndërsa në Kodin e Procedurës Penale përdoret termi “person i dëmtuar” nga vepra penale. Në praktikë autoritetet i referohen Konventës së KE për përkufizimin e “viktimës së trafikimit”.

Janë zhvilluar disa përkufizime bazë të parashikuara në *Procedurat Standarde të Veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave apo viktimave të mundshme të trafikimit* (PSV). Sipas këtyre procedurave, një viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore është personi objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, në bazë të shkronjës “e” të nenit 4 të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”. Viktimë e

40

mundshme e trafikimit të qenieve njerëzore është përkufizuar personi për të cilin/ të cilën agjencitë, institucionet përgjegjëse për identifikimin fillestar, gjejnë se mund të jetë trafikuar.

PSV parashikojnë autoritetet kompetente për të vendosur nëse një person është viktimë apo viktimë e mundshme e trafikimit të qenieve njerëzore. Sipas Procedurave Standarde, një person mund të konsiderohet viktimë, pavarësisht faktit nëse autori është identifikuar, arrestuar, ndjekur penalisht apo dënuar dhe pavarësisht lidhjeve familjare ndërmjet viktimës dhe trafikuesit.

Ligji nr. 108/2013 “Për të huajt” përkufizon si viktima të trafikimit të qenieve njerëzore “subjektet që kanë përfituar leje qëndrimi nga Republika e Shqipërisë si pasojë e statusit të tyre si viktima trafikimi”.

Ka një sërë ligjesh që parashikojnë të drejta specifike për viktimat e trafikimit:

- Në fondin e posaçëm për parandalimin e kriminalitetit është parashikuar dhënia e ndihmës viktimave të krimit të organizuar dhe të dhunës, si dhe nxitja e programeve sociale për këto kategori, duke destinuar pasuritë në administrim të ministrisë që mbulon çështjet sociale³¹.
- Ligji “Për ndihmën juridike” parashikon se përfiton ndihmë juridike falas personi që është viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore.³²
- Ligji “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” parashikon se viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror deri në çastin e punësimit të tyre, mund të përfitojnë ndihmë ekonomike (neni5, pika 4)³³.

31 Neni 37/c, Ligji Nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

32 Ligji nr. Nr. 10 039 datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, i ndryshuar me ligjin nr. 143/2013.

33 Ligji nr. 10 252, datë 11.3.2010, “Për disa shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 “për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, në nenin 4, pas pikës 22 shtohet pika 23, përkufizon termin viktimë e trafikimit si personin fizik, që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, sipas përkufizimit të shkronjës “e” të nenit 4 të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”

Identifikimi

Prej vitit 2011, identifikimi dhe referimi i viktimave /viktimave të mundshme të trafikimit kryhet nga punonjësi social dhe specialisti i sektorit kundër trafikëve të paligjshme sipas Procedurave Standarde të Veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave apo viktimave të mundshme të trafikimit (PSV) të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave³⁴. PSV përcakton autoritetet kompetente që vendosin nëse një person është viktimë apo viktimë e mundshme e trafikimit të qenieve njerëzore.

Seksioni i antitrafikimit i policisë në rrethe është një nga dy strukturat e vetme përgjegjëse për identifikimin formal të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore. Sipas Procedurave të Veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, Agjencia përgjegjëse për identifikimin formal në kufi dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë është grupi/agjencia që kryen intervistën formale të personave të regjistruar si viktimë të mundshme të trafikimit. Grupi përfshin një oficer të seksionit të Policisë së Shtetit për luftën kundër trafikimit të paligjshëm dhe një punonjës social nga Zyra Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror që kryejnë detyrat e caktuara në përputhje me ligjin në qarkun ku personi i identifikuar formalisht ndodhet në atë moment³⁵.

Sipas PSV, të gjitha strehëzat, anëtare të Mekanizmit Kombëtar të Referimit janë të detyruara që çdo VT/VMT të akomoduar apo trajtuar në strehën e tyre fillimisht ta identifikojnë si të tillë mbështetur në PSV-të dhe procesin e identifikimit ta formalizojnë me procesverbalin³⁶ dhe formatin e përfundimit të intervistës formale. Këto janë dy dokumente të firmosura nga personat e autorizuar në bazë të vendimit të sipërpërmendur dhe janë të vetmet dokumente që mund të shërbejnë si "vërtetim" për statusin e një personi si viktimë apo viktimë e mundshme e trafikimit.

34 Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 582, datë 27.07.2011 "Për procedurat standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit".

35 <http://www.albania.iom.int/publications/brochures/Brochure-Anti%20Trafficking%20Police%20in%20support%20of%20VoTs%20-%20ENG.pdf>

36 Sipas PSV, gjatë intervistës qëllimi i procesverbaleve i shpjegohet në mënyrë të kuptueshme personit të intervistuar (dhe kujdestarit ose prindit në rastin e të miturve), si dhe mënyra se si mbahen këto procesverbale dhe kush ka akses në to.

42

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit i vitit 2013 vlerëson se në Shqipëri në vitin 2013 qeveria, në bashkëpunim me drejtoritë e policisë dhe OJF-të, ka ngritur tri njësi të lëvizshme identifikimi, në përbërje të së cilave janë një punonjës policie dhe një punonjës social i një OJF-je. Këto njësi lëvizëse kanë detyrën e identifikimit në komunitetet lokale të viktimave të mundshme të trafikimit.

Në praktikën e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare të ofrimit, informimit dhe këshillimit ligjor, janë identifikuar raste të viktimave të mundshme që nuk dëshirojnë t'u shpjegojnë autoriteteve rrethanat e tyre për shkak të mungesës së besimit dhe frikës për sigurinë fizike të tyre dhe familjeve të tyre. Gjithashtu, janë evidentuar raste në të cilat, edhe pas njohjes si viktima trafikimi, gratë nuk i adresojnë çështjet e tyre pranë autoriteteve përkatëse në rajonin ku ato jetojnë me qëllim që të përfitojnë nga mbështetja financiare, sepse ato kanë frikë për sigurinë e tyre dhe se mund të përballen me paragjykimet e personave përgjegjës që do t'u ofrojnë shërbime. Kjo gjetje rezultoi edhe nga eksperiencat e Qendrës "Të ndryshëm dhe të barabartë", e cila është një qendër që ofron akomodim dhe ndihmë psikologjike për viktimat, me të cilën Qendra për Nisma Ligjore Qytetare bashkëpunon në vazhdimësi.

IV. PJESA 4

AKSESI TEK NDIHMA LIGJORE DHE PËRFAQËSIMI LIGJOR

Viktimat kanë të drejtën për këshillim dhe përfaqësim ligjor për t'i informuar ato në lidhje me rolin e tyre në procedimet penale, për të mbrojtur interesat e tyre, për të dëgjuar pikëpamjet e tyre, si dhe për t'i marrë ato parasysh në procedimin penal. Kjo përfshin edhe procedimin civil, ose procedime të tjera, për të kërkuar kompensim për dëmet që kanë pësuar. Ndihma ligjore dhe përfaqësimi duhet të jenë pa kosto, nëse viktima nuk ka burime të mjaftueshme financiare.

E drejta e viktimave të trafikimit për mbështetje dhe ndihmë ligjore pa pagesë, sipas kushteve të parashikuara nga legjislacioni kombëtar për kohëzgjatjen e veprimeve penale, civile, apo çdo veprimi tjetër kundër trafikantëve, përfshirë këtu edhe për qëllimin e fitimit të kompensimit, është formuluar në dokumente të ndryshme ndërkombëtare dhe Evropiane, përfshirë këtu:

- Konventën e Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore
- Rekomandimin e Këshillit të Evropës (2006)8 mbi asistencën ndaj viktimave të krimit³⁷;

44

- Direktivën 36/11/EU mbi trafikimin e qenieve njerëzore³⁸;
- Direktivën 2012/29/EU (Direktiva mbi viktimën)³⁹;
- Udhëzimet e rekomanduara mbi të drejtat e njeriut dhe trafikimin e qenieve njerëzore nga Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (Parimi 9 & Udhëzimi 9(3))⁴⁰
- Deklaratën e OKB-së mbi parimet bazë të drejtësisë për viktimat e krimit dhe abuzimin me pushtetin.⁴¹

Neni 15(2) i Konventës së Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, u kërkon shteteve palë të “parashikojnë në ligjin e tyre të brendshëm të drejtën për mbështetje dhe ndihmë ligjore falas për viktimat sipas kushteve të parashikuara nga ligji kombëtar”.

Rekomandimi i Këshillit të Evropës (2006) 8 u kërkon shteteve palë që t’u sigurojnë viktimave akses efektiv në drejtësi.

Neni 12(2) i Direktivës 36/2011/EU u kërkon shteteve anëtare “të sigurojnë që viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore të kenë akses pa vonesë për këshillim ligjor, si dhe, në përputhje me rolin e viktimave në sistemin përkatës të drejtësisë, për përfaqësim ligjor, duke përfshirë qëllimin e kërkimit të kompensimit. Këshillimi ligjor dhe përfaqësimi ligjor duhet të jenë pa pagesë kur viktimat nuk ka burime të mjaftueshme financiare”.

Udhëzimet e rekomanduara nga OHCHR Mbi të drejtat e njeriut dhe mbi trafikimin e qenieve njerëzore kërkojnë ofrimin e ndihmës ligjore për viktimat e trafikimit në një gjuhë që ato e kuptojnë, në lidhje me procedimet penale dhe civile, si dhe në lidhje me masat e tjera që merren kundër trafikantëve.

38 Direktiva 2011/36/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e dates 5 prill 2011 mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave, si dhe zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA [OJ L 101 e 15.4.2011].

39 Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e dates 25 tetor 2012 që vendos standardet minimum mbi të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, dhe zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA.

40 E vlefshme në: <http://www.ohchr.org/Documents/Publications/Traffickingen.pdf>.

41 Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40/34, E vlefshme në: <http://www.un.org/documents/ga/res/40/a40r034.htm>.

Dispozita e dhënies së ndihmës kompetente viktimës gjatë gjithë procesit ligjor është një nga parimet bazë të drejtësisë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për viktimat e krimit.

Aksesi për ndihmë ligjore përpara, gjatë dhe mbas gjyqit nuk është vetëm i rëndësishëm për të mbrojtur interesat e viktimës gjatë procedimeve penale dhe procedimeve të tjera, por edhe për të drejtën e kompensimit. Nëse viktimave u ofrohet ndihmë ligjore, ato janë në gjendje të kërkojnë kompensim në mënyrë të efektshme, si dhe të kuptojnë kompleksitetin e procedurave të gjyqit. Gjithashtu aksesit për ndihmë ligjore është identifikuar, si shqetësim nga Komiteti CEDAW, që në vërejtjet përmbyllëse të vitit 2010 mbi Shqipërinë rekomandoi që viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore u duhet garantuar ndihma ligjore falas (CEDAW/C/ALB/CO/3)⁴².

Situata aktuale

Megjithëse ofrimi i ndihmës juridike për viktimat e trafikimit është një detyrim që rrjedh nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, ligji ende nuk garanton të drejtën e viktimave të trafikimit për t'u përfaqësuar me avokat në procedimin penal dhe në procedimet e tjera përkatëse, duke përfshirë edhe procedurat për kompensim. Ndërsa kohët e fundit ligje specifike, si ligji nr. 10 039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike", i ndryshuar parashikojnë të drejtën e një avokati dhe të ndihmës juridike falas për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, kjo nuk garantohej në Kodin e Procedurës Penale. Ka ende pengesa serioze për t'u kapërcyer, në mënyrë që të zbatohet aktualisht kjo e drejtë.

Që nga viti 2013, viktimat e trafikimit kanë të drejtën për ndihmë juridike falas bazuar në nenin 13 pika 1(c), "Personat që kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë juridike" të ligjit "Për ndihmën juridike":⁴³

1. *Të drejtën për të përfitur ndihmë juridike e kanë personat, të cilët:*
 - a) *kërkojnë të mbrohen me avokat në procesin penal në të gjitha fazat e tij dhe, që për shkak të pamundësive financiare, nuk kanë mundur të zgjedhin një avokat apo kanë mbetur pa të;*

42 E vlefshme në: <http://www2.ohchr.org/english/bodies/cedaw/docs/co/CEDAW-C-ALB-CO-3.pdf>.

43 Ligji nr. 143/2013, "Për disa shtesa në ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008 'Për ndihmën juridike'".

46

- b) kanë nevojë për ndihmë juridike në çështjet civile ose administrative, por nuk kanë mjete të mjaftueshme për ta paguar këtë ndihmë juridike apo çështjet janë tepër komplekse, nga ana e përmbajtjes dhe e procedurës. Në këtë rast, personi, që ta përfitojë ndihmën juridike, duhet të vërtetojë se përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet për t'u përfshirë në to.
- c) kanë nevojë të mbrojnë të drejtat e tyre, nëpërmjet paraqitjes së kërkesëpadisë, por nuk kanë mjete të mjaftueshme për të paguar taksën mbi aktet, si dhe shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore. Në këtë rast, personi, që ta përfitojë ndihmën juridike, duhet të vërtetojë se: i. përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet për t'u përfshirë në to; ose ii. është viktimë e dhunës në familje ose viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore për çështjet gjyqësore që lidhen me to.
2. Ndhimën juridike e përfitojnë edhe të miturit, për të cilët mbrojtja në procedimin penal dhe në gjykim është e detyrueshme me ligj.
 3. Ndhima juridike mund të kërkohet para, gjatë dhe pas zhvillimit të procesit gjyqësor.
 4. Personi, i cili përfiton ndihmë juridike, ka detyrimin të bashkëpunojë me Komisionin Shtetëror për Ndhimën Juridike dhe avokatin që siguron ndihmën juridike, të japë informacion të vërtetë, për të cilin është kërkuar ndihma juridike, si dhe të sigurojë në kohë çdo informacion për rrethanat dhe kushtet, që kanë ndryshuar shkaku e dhënies së ndihmës.
 5. Moszbatimi i pikës 4 të këtij neni nga personi, që përfiton ndihmën juridike për çështjet civile ose administrative, përbën shkak për ndërprerjen e menjëhershme të përfitimit të kësaj ndihme juridike.

Teksti i nënvizuar në nenin 13 pika (1) "c" është parashikuar vetëm me Ligjin nr. 143/2013, "Për disa shtesa në ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike". Ka mungesë të dhënash në lidhje me numrin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore që kanë marrë aktualisht ndihmë juridike falas.

Mbështetja e sektorit jofitimprurës për viktimat e trafikimit

Në praktikë, në shumicën e rasteve viktimat e trafikimit marrin ndihmë ligjore falas nga avokatë të OJQ-ve të tilla si QNL, si dhe të disa OJQ⁴⁴-ve të tjera, të financuara

44 Qendra Psikosociale "Vatra" në Vlorë, Qendra "Të ndryshëm dhe të barabartë", në Tiranë, "World

nga donatorë në kuadrin e projekteve. QNL bashkëpunon me Strehëzën “Të ndryshëm dhe të barabartë” për t’u ofruar viktimave të trafikimit ndihmë ligjore. Në vitin 2011 dhe 2012, QNL u dha ndihmë ligjore falas për 32 viktima të trafikimit: 15 në vitin 2011 dhe 17 në vitin 2012. Në vitin 2012, 4 nga këto raste iu referuan QNL-së nga zyra e prokurorisë.

Bazuar në raportin e Qendrës “Të ndryshëm dhe të barabartë” për vitin 2013, kjo organizatë në bashkëpunim me QNL, bëri një vlerësim ligjor për 32 raste të reja që hynë në programin e tyre. Viktimat u informuan rreth të drejtave të tyre dhe në vazhdimësi ju ofrua ndihmë ligjore. Në 15 raste të reja të referuara tek Qendra “Të ndryshëm dhe të barabartë”, viktimat denoncuan trafikantët e tyre. Rastet e tyre u morën për shqyrtim nga Prokuroria e Krimeve të Rënda.⁴⁵

Një tjetër vështirësi është detyrimi për të paguar tarifën gjyqësore.⁴⁶ Së bashku me ndryshimet në ligjin “Për ndihmën juridike” më 2013 u shtua një paragraf i ri tek neni 11, që thotë:

Ndihma juridike përfshin edhe përjashtimin në proceset gjyqësore civile dhe administrative të individit nga pagesa e taksës mbi aktet, si dhe të shpenzimeve të nevojshme për njoftime ose shërbimet e tjera gjyqësore.

Për arsye se ky ndryshim është i kohëve të fundit, nuk është akoma e mundur për të vlerësuar zbatimin e tij.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të përmendet se Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr.7, të datës 27 shkurt 2013 ka gjykuar se gjykata nuk pengohet të përjashtojë paditësin nga pagesa e tarifës juridike⁴⁷ në rastet kur ai/ajo nuk ka mundësi financiare për të bërë këtë pagesë. Kjo do të thotë se ka hapësirë për gjyqtarin të vlerësojë plotësimin e kësaj kërkesë procedurale dhe të përjashtojë personin përkatës nga pagesa mbi bazën e gjykimit rast-mbas-rasti, kështu që

“Vision” në Elbasan, etj. janë disa OJQ që punojnë mbi këto çështje.

45 <http://www.differentandequal.org/Raporti%20Vjetor%202013%20-%20D&E.pdf>.

46 Një pengesë e madhe për viktimat e trafikimit për të pasur akses në gjykatë, ishte se ato nuk ishin të përjashtuara nga pagesa e taksave gjyqësore, si dhe nga shpenzimet gjyqësore dhe të përbarimit. Një viktimitë e trafikimit që donte të kërkonte kompensim duhet ti paguante gjykatës 1% të shumës që ajo kërkonte për kompensim, dhe 3% të shumës që gjykata i nje, shërbimit të përbarimit si kompensim për zbatimin e vendimit të gjykatës.

47 Këto tarifa gjithashtu aplikohen për viktimën/palën e dëmtuar në procedimet penale.

48

nuk e pengon të drejtën e tij, ose të saj, për të pasur akses në gjykatë. Gjykata mund ta bëjë këtë duke shqyrtuar dokumentet e dorëzuara nga vetë qytetari/qytetarja për të provuar pamundësinë e tij/të saj për të paguar. Kjo situatë e bën të nevojshme që të merret në konsideratë statusi financiar i viktimave të trafikimit për të vlerësuar nëse viktimat është mjaftueshëm e varfër për ta përjashtuar atë nga taksat juridike dhe nga shpenzimet.

Roli i punonjësve socialë në dhënien e informacionit ligjor

Punonjësit socialë të qendrave rezidenciale për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore luajnë një rol të rëndësishëm në pajisjen e viktimave të trafikimit me informacion ligjor kur ata i intervistojnë viktimat. Kjo përgjegjësi e punonjësve socialë rrjedh nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.195, datë 11.04.2007, "Standardet e shërbimeve të kujdesit social për personat që janë viktimat të trafikimit, ose viktimat të mundshme të trafikimit, në qendrat rezidenciale."⁴⁸ Pavarësisht rolit të punonjësve socialë, është e domosdoshme që viktimave t'u jepet ndihmë ligjore e specializuar që nga kontakti i tyre i parë me autoritetet.

Akresi i viktimave të trafikimit tek ndihma ligjore falas e financuar nga shteti

Komisioni Shtetëror për Ndhimën Juridike është autoriteti që vendos në lidhje me caktimin e një avokati. Viktimat nuk lejohen të zgjedhin avokatin e tyre. Sipas Procedurave Standarde, grupi që përfundon intervistimin formal dhe që vendos mbi statusin e një viktime, ose të një viktime të mundshme, nuk përfshin ndonjë avokat. Kështu që viktimat nuk ka akses tek ndonjë avokat që nga kontakti i parë me autoritetet.

Fëmijët

Nuk ka dispozita specifike në lidhje me ndihmën ligjore dhe përfaqësimin e viktimave-fëmijë. Viktimat fëmijë përfitojnë nga ndihma ligjore falas si çdo viktimë e trafikimit.⁴⁹

48 <http://mpcs.gov.al/strategji-standarte>.

49 Ligji "Për ndihmën juridike falas", i ndryshuar, Ligji Nr. 143/2013, "Për disa shtesa në ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008 'Për ndihmën juridike'".

Kur viktima është një fëmijë, prindërit, kujdestari, ose përfaqësuesi ligjor përfaqësojnë interesat e fëmijës, kur ai/ajo është palë në procedimet ligjore për të kërkuar dëmshpërblim. Kur prindërit/përfaqësuesit ligjorë të fëmijës pengohen nga sigurimi i interesit më të lartë për fëmijën dhe/ose nga përfaqësimi i fëmijës, atëherë një kujdestar, ose një përfaqësues caktohet për viktimën fëmijë. Kjo rregullohet nga Kodi i Familjes.

Problemet kryesore

Fakti se, që nga ndryshimi i ligjit në vitin 2013, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore kanë të drejtën e ndihmës ligjore është një hap i rëndësishëm përpara në aksesin e tyre në sistemin e drejtësisë. Megjithatë, pavarësisht këtij hapi pozitiv në lidhje me kuadrin ligjor, ka akoma shumë për të bërë për të garantuar këtë të drejtë në praktikë. Kjo përfshin riorganizimin e procedurave dhe caktimin e një buxheti, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi ligjin e ri përmes institucioneve përkatëse, duke u dhënë informacion viktimave dhe duke përmirësuar cilësinë e ndihmës ligjore.

Për të zbatuar aktualisht këtë të drejtë, rekomandohet që Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike të nxjerrë udhëzime në të cilat të vendosen përgjegjësitë specifike në lidhje me ndihmën ligjore për viktimat e trafikimit dhe përfaqësimin e tyre në procedimin gjyqësor.

Gjithashtu rekomandohet që një pjesë e buxhetit vjetor të Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike të përcaktohet për dhënien e ndihmës ligjore për viktimat e trafikimit por duhet të rritet edhe niveli i ndërgjegjësimit mbi faktin se viktimat e trafikimit janë të përjashtuara nga pagesa e taksave gjyqësore. Kjo siguron aksesin e tyre në sistemin e drejtësisë.

Praktikat e OJQ-ve që punojnë në mbështetje të viktimave tregojnë që ato nuk informohen mbi të drejtën e tyre për ndihmë ligjore dhe se si të aplikojnë për të tek Komisioni Shtetëror i Ndhmës Juridike, si dhe as për të drejtën e tyre për t'u përjashtuar nga pagesa e tarifave gjyqësore.

Gjithashtu e drejta për ndihmë ligjore e viktimave të trafikimit shtrun për diskutim çështjen e cilësisë së kësaj ndihme të siguruar për to. Avokatët e financuar përmes

50

buxhetit të shtetit nuk janë të specializuar në këtë fushë. Kohët e fundit, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në bashkëpunim me organizata të ndryshme të të drejtave të njeriut, kanë organizuar trajnime të fokusuara tek të drejtat e viktimave të trafikimit. QNL ka organizuar disa trajnime për avokatët mbi këtë temë.

Është e qartë se cilësia e avokatëve të financuar nga shteti ka nevojë të përmirësohet. Ligji "Për ndihmën juridike" parashikon që Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike të monitorojë cilësinë e ndihmës ligjore të ofruar, por ka një nevojë të ngutshme dhe për një sistem monitorimi për të siguruar që këta avokatë të trajnohen më mirë dhe të ndërgjegjësohen më shumë ndaj çështjes së trafikimit të qenieve njerëzore, ndaj të drejtave të viktimave, etj.

Raport progresi i BE-së i vitit 2013 mbi Shqipërinë vë re:

"Për sa i përket aksesit në drejtësi, ligji për ndihmën juridike u ndryshua në maj, me qëllim përjashtimin e viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje nga tarifat gjyqësore, si edhe ngritjen e zyrave vendore të ndihmës juridike. Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike u kërkoi avokatëve të aplikojnë që të renditen si avokatë falas të ndihmës juridike. Zbatimi i ligjit ka ecur shumë ngadalë dhe buxheti për zyrat vendore që do të ngrihen në planin afatshkurtër është i pamjaftueshëm. Pavarësisht ndryshimeve të miratuara në maj, aksesit në drejtësi është penguar nga tarifat e larta gjyqësore. Aplikantët që kërkojnë ndihmë juridike falas duhet të dorëzojnë shumë dokumente nga institucione shtetërore të ndryshme. Pjesa më e madhe e ndihmës juridike falas jepet nga shoqëria civile"⁵⁰.

Nuk ka informacion on-line të vënë në dispozicion nga Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike në lidhje me numrin e përfituesve për vitin 2013. Sipas "website" të Ministrisë së Drejtësisë, megjithatë, Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike ka rishikuar 27 raste për vitin 2011 dhe 4 raste për periudhën janar-maj 2012, për të cilat është dhënë ndihmë juridike.⁵¹

50 E vlefshme në:

<http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/progres-raporte/progres-raporti-2013&page=1>

51 Mandro, A., "Statusi i zbatimit të vërejtjeve përmbyllëse të Komitetit të CEDAW ". Periudha e raportimit korrik 2010 - nëntor 2012.

V. PJESA 5

TË DREJTAT E VIKTIMËS

5.1. E drejta për informacion

Viktimat kanë të drejtën për informacion në një gjuhë që ato e kuptojnë, në lidhje me shërbimet ndihmëse në dispozicion dhe se si t'i aksesojnë këto shërbime, të drejtat e procedurat e përshtatshme gjyqësore dhe administrative, duke përfshirë edhe informacionin në lidhje me kompensimin dhe aksesin tek ndihma ligjore.

E drejta e viktimave të trafikimit për informacion, midis dokumenteve të tjera, është vendosur tek Protokollin e KB kundër trafikimit, tek Konventa e Këshillit të Evropës mbi masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Rekomandimi i Këshillit të Evropës (2006) 8, Direktiva e BE mbi trafikimin, Direktiva e BE për viktimën; dhe Deklarata mbi parimet bazë të drejtësisë.

Neni 6(2) i Protokollit të KB kundër trafikimit kërkon nga shtetet palë të sigurojnë që sistemet ligjore të vendit të përmbajnë masa për t'u dhënë viktimave të trafikimit informacion mbi procedurat respektive gjyqësore dhe administrative, si dhe t'u ofrojnë atyre asistencë për të mundur që pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre të prezantohen dhe të merren në konsideratë gjatë procedimeve penale.

Neni 12(d) i Konventës Evropiane mbi masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore kërkon nga shtetet palë të marrin masa që t'u ofrojnë viktimave mbështetje, duke përfshirë "këshillim dhe informacion, në veçanti në lidhje me të drejtat e tyre ligjore dhe shërbimet e vlefshme për to në një gjuhë që ato të mund ta kuptojnë". Neni 15 (1) i detyron shtetet që të "sigurojnë që viktimat të kenë akses që nga kontakti i

52

tyre i parë me autoritetet kompetente tek informacioni mbi procedurat përkatëse gjyqësore dhe administrative në një gjuhë të cilën ato mund ta kuptojnë”.

Rekomandimi i KE (2006) 8 kërkon që viktimave t’u jepet akses në informacion në lidhje me shërbimet, procedurat ligjore, mbi rolin e viktimave në këto procedura, si dhe informacion rreth të drejtave të tyre për t’u mbrojtur dhe për kompensim nga autori i veprës penale ose nga shteti, këshillim dhe ndihmë ligjore.

Neni 4 i Direktivës së BE për viktimën (Direktiva 2012/29/BE) i detyron shtetet palë për të siguruar që viktimave t’u ofrohet informacioni i mëposhtëm, pa ndonjë vonesë të panevojshme, që nga kontakti i parë me autoritetin kompetent:

- a) tipi i ndihmës që mund të përfitojë dhe nga kush, duke përfshirë, aty ku duhet, informacion bazë në lidhje me aksesin për ndihmë mjekësore, çdo ndihmë mjekësore të specializuar, duke përfshirë ndihmë psikologjike, si dhe akomodim alternativ;
- b) procedurat për të ngritur akuzë në lidhje me ndonjë vepër penale dhe në lidhje me rolin e viktimave lidhur me procedura të tilla;
- c) në cilat kushte ato mund të përfitojnë mbrojtje, duke përfshirë masat mbrojtëse;
- d) në cilat kushte ato mund të kenë akses në këshillim ligjor, ndihmë ligjore, si dhe në ndonjë këshillim tjetër;
- e) në cilat kushte ato mund të kenë akses për kompensim;
- f) në cilat kushte ato kanë të drejtën për përkthim (verbal dhe të materialeve)
- g) nëse ato janë rezidente në një shtet anëtar që është i ndryshëm nga shteti ku është kryer vepra penale, çdo masë e veçantë, procedurë ose marrëveshje, të cilat janë të vlefshme për të mbrojtur interesat e tyre në shtetin anëtar ku është bërë kontakti i parë me autoritetet kompetente;
- h) procedurat e vlefshme për t’u ankuar, kur të drejtat e tyre nuk respektohen nga autoriteti kompetent që operon brenda kontekstit të procedimit penal;
- i) detajet e kontaktit për të komunikuar në lidhje me rastin e tyre;
- j) shërbimet e vlefshme të drejtësisë restauruese;
- k) si dhe në cilat kushte mund të rimbursohen shpenzimet e kryera si rezultat i pjesëmarrjes së tyre në procedimet penale.

Ofrimi i informacionit për viktimat rreth ecursisë së procedimeve dhe mundësia për të lejuar viktimat për të shprehur shqetësimet e tyre në një fazë të përshtatshme të procedimeve përbën një nga parimet bazë të Deklaratës së Kombeve të Bashkuara mbi parimet bazë të drejtësisë.

E drejta e viktimave për informacion lidhet ngushtë me të drejtën e tyre për kompensim dhe të drejta të tjera. Një viktimë mund t'i ushtrojë të drejtat e tij/saj vetëm nëse ai ose ajo i njeh ato. Viktimat e trafikimit zakonisht kanë informacion të kufizuar mbi funksionimin e drejtësisë penale dhe kjo i pengon për ushtrimin e plotë të të drejtave të tyre.

Gjithashtu, Komiteti CEDAW në vërejtjet e tij përmbyllëse, në vitin 2010, për Shqipërinë ngriti çështjen e garantimit të të drejtës për informacion të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.

Situata aktuale

Bazuar në Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) të aprovuara nga Këshilli i Ministrave,⁵² oficerët e policisë së kufirit dhe migracionit informojnë viktimat mbi të drejtat dhe mundësitë për asistencë. Informacioni jepet mbasi personi identifikohet si viktimë (viktimë e mundshme) e trafikimit. Në rastin e viktimave të dhunës në familje këtë informacion e japin oficerët e policisë dhe organizatat jofitimprurëse.

Viktimat e trafikimit nuk informohen nga një avokat, sepse tek autoritetet nuk ka një avokat në kontaktin e parë me viktimat. Sipas Kodit të Procedurës Penale, viktima nuk është palë në procesin penal, prandaj nuk ka të drejtën e një avokati.

Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon ndonjë detyrim ligjor për prokurorët për t'u dhënë informacion ligjor viktimave të trafikimit. Megjithatë, në praktikë, prokurori dhe oficeri i policisë i ngarkuar me hetimin e rastit e informojnë viktimën rreth të drejtave dhe detyrave të tyre në lidhje me procesin penal. Ata mbajnë kontakt të vazhdueshëm me viktimën (edhe përmes qendrave ku është akomoduar viktima) në lidhje me progresin, me fazat dhe përfundimin e hetimeve, në lidhje

52 Vendimi nr. 582, datë 27.07.2011, "Mbi Procedurat Standarde të Veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit".

54

me akuzat e ngritura, me masat e sigurisë personale përkundrejt personave të dyshuar, me datat e gjyqit, si dhe mbi progresin e çështjes penale deri në vendimin përfundimtar. Nëse çështja pushohet, prokurori, sipas nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale, ka detyrimin të njoftojë viktimën (palën e dëmtuar) mbi këtë vendim, e cila ka të drejtën që të apelojë vendimin.

Bazuar në eksperiencën e QNL, viktimat e trafikimit gjithashtu merr informacion ligjor nga prokurori mbi të drejtën e kompensimit.

Një burim i rëndësishëm informacioni për viktimat janë OJF-të, përmes kontaktit të viktimës me punonjës të social. Si rrjedhim, viktimat informohen vazhdimisht përmes bashkëpunimit me organizata të specializuara, të tilla si QNL dhe organizata të tjera.

Informimi i personave të trafikuar mbi të drejtat e tyre, duke përfshirë të drejtën për të denoncuar trafikantët, si dhe të drejtën për kompensim, duhet të jetë një detyrim për të gjitha palët përgjegjëse, në çdo hap të procesit.

Megjithëse është vendosur një praktikë e informimit të viktimave, kjo nuk e justifikon mungesën e dispozitave në legjislacionin e brendshëm që të parashikojnë detyrimin e organeve përgjegjëse për të informuar viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Është e nevojshme për shtetin që të marrë masa ligjore për të siguruar që viktimat e trafikimit të pajisen me informacion që nga kontakti i tyre i parë me autoritetet përmes procedurave ligjore.

Fëmijët

Nuk ka dispozita specifike në lidhje me informimin e viktimave fëmijë dhe adoleshentë (d.m.th.. për informimin e viktimave nën 18 vjeç). Në praktikë aplikohet e njëjta gjë si për viktimat fëmijë, ashtu edhe për viktimat mbi 18 vjeç.

Problemet kryesore

Tre problemet kryesore në praktikë në lidhje me informimin e viktimës janë:

1. *Legjislacioni shqiptar nuk parashikon ndonjë detyrim për policinë, prokurorinë, ose për gjyqtarët, për të informuar viktimat e trafikimit të*

qenieve njerëzore mbi të drejtat e tyre, në mënyrë që t'u jepet atyre siguri dhe për t'i bërë ato që të kuptojnë se ka instrumenta ligjorë dhe socialë që ato mund t'i përdorin në avantazhin e tyre.

2. *Viktimat nuk marrin informacion të plotë në lidhje me të drejtën e tyre për të kërkuar kompensim nga keqbërësi dhe nga skema shtetërore sipas Ligjit nr. 10192, 3 dhjetor 2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive".*
3. *Viktimat nuk përfaqësohen dhe nuk informohen nga një avokat në të gjitha fazat në lidhje me të drejtat e tyre ligjore, duke filluar që nga momenti i identifikimit.*

Kjo situatë shpjegohet me fokusin e dobët mbi të drejtat e viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore.

Kjo do të thotë se ka një nevojë për përmirësim të legjislacionit dhe të punës së agjencive përkatëse në lidhje me dhënien e informacionit për viktimat. Një formë për të siguruar nëse informacioni është dhënë është përmes fletëpalosjeve në të cilat të drejtat e viktimave të trafikimit përshkruhen në një gjuhë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme.

5.2. E drejta për të mos bashkëpunuar me organet e zbatimit të ligjit

Viktimat kanë të drejtën të refuzojnë bashkëpunimin me autoritetet e procedimit penal.

Viktimat nuk janë të detyruara të ngrenë akuza, ose të bashkëpunojnë me autoritetet. Identifikimi formal kryhet vetëm përmes intervistimit të viktimës së mundshme me dëshirën e tij/saj të shprehur dhe vetëm kur ekzistojnë kushtet për një intervistim normal.⁵³ Bazuar në procedurat standarde, identifikimi formal bëhet nga autoritetet.

53 www.albania.iom.int/publications/brochures/BrochureAnti%20Trafficking%20Police%20in%20support%20of%20VoTs%20-%20ENG.pdf.

56

Intervista kryhet vetëm me pëlqimin e personit. Para intervistës intervistuesit:

- sqarojnë qëllimin e intervistës
- sigurojnë nëse viktimia (viktima e mundshme) e njeh pozitën e intervistuesve dhe të personave të pranishëm gjatë intervistimit
- sigurohen që personi është gati për të filluar intervistën
- sigurohen që personi të ndihet mirë me personat e pranishëm gjatë intervistimit dhe të ndihet i sigurt në vendin ku kryhet intervistimi
- sigurohen që personi e kupton dhe e pranon se me përfundimin e intervistës, ai/ajo mund të kontaktohen ose të intervistohen përsëri nga intervistuesit.
- pyesin nëse ai/ajo ndihet komod me praninë e përkthyesit apo pa praninë e tij.

Fëmijët

Bazuar tek PSV, në rastin e minoreneve procedura është si vijon:⁵⁴

4. *Punonjësi i policisë i SLKTP*⁵⁵ *paraqitet menjëherë në pikën e kalimit kufitar mbas njoftimit të marrë nga punonjësi i policisë së kufirit dhe migracionit për identifikimin e një viktime (viktime të mundshme) minorene të trafikimit dhe e çon atë në ambientet e intervistimit të policisë, në sektorin e luftës kundër trafikeve të paligjshme;*
5. *Punonjësi i policisë së SLKTP thërret pjesëtarin tjetër të grupit/strukturës për identifikimin formal (G/SPIF)⁵⁶, dhe punonjësin social të zyrës rajonale të shërbimit social të vendit ku do të kryhet intervistimi; Në rast se i mituri/e mitura është i/e huaj, punonjësi i policisë së SLKTP kërkon një përkthyes (të njëjtin përkthyes që është përdorur në kufi) dhe nënshkruan me të marrëveshjen e konfidencialiteti;*
6. *Punonjësi i policisë së SLKTP njofton prindin ose kujdestarin e të miturit/ të miturës të paraqiten në polici, nëse prindi apo kujdestari nuk ka qenë i pranishëm deri në atë kohë;*

54 www.albania.iom.int/publications/brochures/BrochureAnti%20Trafficking%20Police%20in%20support%20of%20VoTs%20-%20ENG.pdf.

55 Sektori i luftës kundër trafikeve të paligjshme (Policia).

56 Grupi/struktura përgjegjëse për identifikimin formal.

7. Punonjësi i policisë së SLKTP dhe punonjësi social i ZRSHSSH⁵⁷, (G/SPIF) i shpjegojnë të miturit/të miturës VMT dhe prindit/kujdestarit të tij/saj qëllimin e intervistës formale, ndryshimin ndërmjet intervistës dhe kallëzimit penal, mënyrën se si informacioni i marrë gjatë intervistës do të përdoret dhe kërkojnë leje për intervistën formale. Nëse i mituri/e mitura dhe prindi/kujdestari ligjor i tij/saj nuk bien dakord që të kryhet një intervistë formale, ose nëse punonjësi i policisë së SLKTP dhe punonjësi social, (G/SPIF) gjykojnë se intervista duhet të shtyhet për shkaqe të ndryshme, ata vazhdojnë ta konsiderojnë të miturin/të miturën VMT, bazuar tek përcaktimi i punonjësit të PKM⁵⁸, si dhe procedojnë sipas hapave 8 dhe më tej, duke u konsultuar me AP⁵⁹ dhe me vendimin e të miturit/të miturës dhe prindit/kujdestarit ligjor të tij/saj.
8. Nëse informacioni paraprak nuk tregon ndonjë përfshirje të prindit/kujdestarit në trafikim ose në abuzim, G/SPIF kryen intervistën formale të të miturit/të miturës dhe të prindit, ose kujdestarit.
9. G/SPIF kryen një analizë të intervistës dhe nxjerr konkluzione mbi statusin e të miturit/të miturës në lidhje me trafikimin dhe të nevojave të tij/saj për siguri dhe kujdes.
10. Punonjësi social i ZRSHSSH, (anëtar i G/SPIF) informon anëtarin e AP të MPÇSSHB⁶⁰ mbi situatën e të miturit/të miturës dhe konsultohet me të në lidhje me vendosjen e minorenit në ndonjë ambient që është i përshtatshëm për nevojat e tij/saj.
11. G/SPIF informon të miturin/të miturën dhe prindin apo kujdestarin e tij/saj për ndihmën që mund t'i jepet, si dhe i ndihmon ata që të marrin një vendim të informuar në lidhje me ndihmën.
12. G/SPIF e ndihmon të miturin/të miturën dhe prindin apo kujdestarin e tij/saj që të deklarojnë me shkrim vendimin e tyre të informuar për ndihmën.

Këto procedura janë duke funksionuar në praktikë.

57 Zyra rajonale e Shërbimit Social Shtetëror.

58 Policia e kufirit dhe migracionit.

59 Autoriteti përgjegjës.

60 Ministria e Punës, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

5.3. E drejta për mbrojtjen e privatësisë dhe sigurisë përpara, gjatë dhe mbas procedimit penal, si dhe për t'u trajtuar me respekt dhe dinjitet.

Viktimat kanë të drejtën e mbrojtjes së jetës së tyre private dhe të familjes, të të dhënave të tyre personale⁶¹ dhe sigurinë e tyre përpara, gjatë dhe mbas procedimeve penale, si dhe për t'u trajtuar me respekt dhe dinjitet. Ato kanë të drejtën për shërbime përkthimi (pa pagesë) gjatë intervistave, ose marrjes në pyetje. Nëse ato dëshmojnë, ato kanë të drejtë të mbrohen si dëshmitare, si dhe të mbrohen nga kërcënimet, fyerjet, kanosjet, apo nga çdo sulm tjetër, para, gjatë dhe mbas hetimeve, ndjekjes penale dhe gjykimit.

Neni 11 i Konventës së KE mbi masat kundër trafikimit kërkon nga shtetet palë që të mbrojnë jetën private dhe identitetin e viktimës. Kjo përfshin mbajtjen e të dhënave personale në përputhje me Konventën e KE nr. 108⁶² duke inkurajuar edhe median që të mbrojnë jetën private dhe identitetin e viktimës. Gjithashtu, neni 6(1) i Protokollit të KB për trafikimin u kërkon shteteve që të mbrojnë jetën private dhe identitetin e viktimave të trafikimit, ndër të tjera, duke proceduar ligjërisht në mënyrë konfidenciale.

Udhëzimet e OHCHR mbi të drejtat e njeriut dhe trafikimin e qenieve njerëzore theksojnë se identiteti i personave të trafikuar nuk bëhet publik dhe jeta e tyre private respektohet dhe mbrohet deri në masën që është e mundur, duke marrë gjithashtu parasysh të drejtën e çdo personi të akuzuar për një gjykim të drejtë. Personave të trafikuar që më parë u duhet dhënë një paralajmërim i plotë mbi vështirësitë që trashëgohen në mbrojtjen e identiteteve dhe të mos u krijohen

61 'Të dhëna personale' do të thotë çdo informacion që lidhet me një individ të identifikuar, ose të identifikueshëm. Të dhënat konsiderohen personale kur e mundëson këdo që të lidhë informacionin me një person specifik, edhe nëse personi ose organi që mban të dhënat nuk mund ta bëjë atë lidhje. Kjo do të thotë se çdo informacion që identifikon, ose që mund të çojë në identifikimin e një personi (subjekt i të dhënave) nga gjithë pjesa tjetër e personave futet tek të dhënat personale.

62 Konventa e KE për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale (Konventa nr. 108).

pritsmëri të rreme, ose që nuk janë realiste në lidhje me kapacitetet e agjencive ligjzbatuese në lidhje me këtë çështje (Udhëzimet nr. 6.6 të OHCHR).

Për më tepër, duhen marrë masa për të mbrojtur personat e trafikuar nga dëmtimi i mëtejshëm, si dhe të mbrohet siguria e tyre fizike, duke marrë në konsideratë moshën, gjininë dhe nevojat e veçanta të viktimave të trafikimit, veçanërisht nevojat e veçanta të fëmijëve (Protokolli i Trafikimit të KB, neni 6(4) & 6(5); Konventa e KE mbi masat kundër trafikimit, neni 12 & 28).

Personave të trafikuar që veprojnë si dëshmitarë (dhe aty ku është e përshtatshme edhe familjeve të tyre dhe të tjerëve të afërt me ta) u duhet dhënë mbrojtje efektive nga dëmtimet, kërcënimet, hakmarrja potenciale, ose kanosjet nga trafikantët dhe personat që lidhen me ta, gjatë hetimit dhe procesit të gjyqit dhe çdo periudhe pasuese, kur një gjë të tillë e kërkon siguria e personave të trafikuar. Kjo mund të përfshijë dhënien e dëshmisë në një mënyrë që të sigurojë sigurinë e tyre (p.sh. përmes lidhjeve me video), identifikimin e një vendi të sigurtë në vendin e destinacionit; mbrojtjen e identitetit gjatë procedimeve ligjore; identifikimin e opsioneve për qëndrim të vazhdueshëm, vendosjen në një vend tjetër, ose kthimin në atdhe (Konventa e KB mbi krimin e organizuar, neni 25 Konventa e KE mbi masat kundër trafikimit, neni 28 & 30; Udhëzimet nr. 6, 4.10 & 5.8 të OHCHR; Direktiva e BE 36/2011/EU mbi trafikimin, neni 12).

Neni 12 i Direktivës 2011/36/EU mbi trafikimin kërkon që shtetet anëtare të sigurojnë që viktimat e trafikimit të marrin mbrojtjen e duhur mbi bazën e një vlerësimi individual të riskut, ndërmjet të tjerave, duke u dhënë akses në programet e mbrojtjes së dëshmitarit, ose masa të tjera të ngjashme. Për më tepër personat e trafikuar duhet të marrin trajtim specifik duke synuar parandalimin e viktimizimit të dytë duke shmangur, aq sa të jetë e mundur dhe bazuar tek ligji kombëtar, si më poshtë:

- përsëritjen e panevojshme të intervistave gjatë hetimit, procedimit, apo gjyqit;
- kontaktin vizual ndërmjet viktimave dhe të akuzuarve, përfshirë gjatë dhënies së provave në mënyrë të tillë si intervistat dhe ballafaqimi i thënieve, me anë të mjeteve të duhura duke përfshirë përdorimin e teknologjive të duhura të komunikimit;

60

- dhënien e dëshmisë në një seancë të hapur gjyqësore; si dhe
- pyetjet e panevojshme në lidhje me jetën private të viktimës;

Në rast dështimi në mbrojtjen e jetës private dhe të sigurisë së viktimave, apo në trajtimin e tyre me respekt, viktimat dekurajohet për bashkëpunimin me autoritetet në procedimin penal dhe për të kërkuar të drejtat e saj, duke e reduktuar këtë bashkëpunim në një kuadër bosh.

Mbrojtja e të dhënave personale

Në përgjithësi të dhënat personale të personave të trafikuar duhen mbledhur, ruajtur dhe përdorur në përputhje me Ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”⁶³ dhe në përputhje me Konventën e KE për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale (Konventa nr. 108), si dhe në përputhje me akte të tjera ligjore të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Kjo do të thotë se viktimat informohen se kush/ cili organ i mbledh të dhënat e tyre personale; të dhënat e tyre personale nuk nxirren apo ndahen me palët e tjera pa marrë më parë miratimin e informuar dhe të lirë të tyre; të dhënat personale mbledhen vetëm për qëllime të specifikuar, të qarta dhe të ligjshme, në kuadër të detyrave të autoritetit kompetent; të dhënat personale përpunohen vetëm për të njëjtat qëllime për të cilat ato janë mbledhur; përpunimi⁶⁴ i këtyre të dhënave duhet të ketë një bazë ligjore dhe të jenë të përshtatshme, të kenë lidhje dhe të mos jenë të tepruara për sa i përket qëllimit për të cilin ato u mbledhën; të dhënat personale fshihen ose bëhen anonime kur ato nuk kërkohen më për qëllimin për të cilin ato u mbledhën.

Përpara intervistës së identifikimit formal, viktimat informohen (dhe duhet të bjerë dakord) që të dhëna të papersonalizuara (që nuk nxjerrin të dhëna personale), të mbledhura gjatë intervistës, do të prezantohen dhe do të përdoren në përputhje me ligjin për qëllime kërkimore që kontribuojnë në luftën kundër shfrytëzimit dhe trafikimit të personave.

63 Ligji Nr. 9887 datë 10 mars 2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

64 “Përpunimi i të dhënave personale” do të thotë çdo veprim që kryhet mbi të dhënat personale, duke përfshirë mbledhjen, rregjistrimin, ruajtjen, korrigjimin, konsultimin, përdorimin, transmetimin, shpërndarjen, ose edhe vënien në dispozicion, bllokimin, fshirjen, apo shkatërrimin.

Në praktikë, megjithatë, nuk ka probleme në respektimin e këtyre standardeve nga gjykata dhe nga aktorët e tjerë.

Vlerësimi individual i rrezikut

Një vlerësim risku është pjesë e formatit të intervistës formale për të rriturit. Sipas këtij formati rreziqet kategorizohen si më poshtë:

- Rrezik i lartë: personi dhe familja e tij/saj duket se janë në rrezik të lartë hakmarrjeje ose kërcënimesh nga trafikantët, ose nga të tjerë. Kërkohen masa për të transferuar përfituesin në një strehë të sigurisë së lartë (me miratimin e personit) dhe për të koordinuar me agjencitë e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e përfituesit dhe familjes së tij/saj.
- Rrezik i moderuar: ka disa të dhëna që personi mund të jetë i rrezikuar nga trafikantët ose nga familjarët e trafikantëve, por këto rreziqe mund të kontrollohen. Kërkohet që të hartohet një plan për të mbrojtur personin nga këto rreziqe.
- Rrezik i ulët: personi nuk duket sikur ka ndonjë kërcënim ndaj tij/saj ose familjes së tij/saj. Nuk nevojitet ndonjë veprim në këtë moment, por duhet të ndërmerren vlerësime të vazhdueshme të sigurisë në rast se ka ndryshime në gjendjen e përfituesit.
- Rrezik i papërcaktuar: ka disa të dhëna që personi mund të jetë në rrezik nga trafikantët ose nga familjarët e trafikantëve, por të dhënat duhen verifikuar në kohën më të shpejtë të mundshme.

Veprime të mëtejshme që duhet të ndërmerren për menaxhimin e rrezikut dhe për ndihmë ndaj personit:

- Denoncimi i veprës penale dhe vlerësimi nëse viktimi mund të përfitojë nga ligji në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve.
- Ndërprerje e marrëdhënieve me persona të përfshirë në krim.
- Masat e marra për mbrojtjen e personave të tjerë që janë në kërcënim/ rrezik.
- Asistencë për kthim të sigurt dhe rehabilitim.

62

- Ndryshim i vendndodhjes së personit.
- Marrëveshje ndërmjet viktimës dhe intervistuesve mbi mënyrën e komunikimit dhe të mbajtjes së kontakteve ne të ardhmen⁶⁵.

E drejta për shërbime përkthimi (pa pagesë) gjatë intervistave dhe marrjes në pyetje

Në përputhje me nenin 98 KPP, viktimat që nuk flasin gjuhën shqipe pyeten në gjuhën e tyre amtare dhe të dhënat/ procesverbalet gjithashtu mbahen në këtë gjuhë. Viktimat që flasin në gjuhë të huaj ndihmohen me një përkthyes në gjuhën e tyre amtare. Përkthyesi caktohet nga prokurori (në fazën e hetimit paraprak) ose nga gjykata (në fazën e shqyrtimit gjyqësor). Përkthyesi caktohet nga lista e përkthyesve të certifikuar nga Ministria e Drejtësisë dhe paguhet nga shteti.

Prania e një personi të besuar gjatë marrjes në pyetje

Viktimat lejohen të shoqërohen nga dikush që ato e zgjedhin vetë, dhe që ato e besojnë gjatë marrjes në pyetje (p.sh. një punonjëse sociale, ose psikologe) nga policia, prokurori, si dhe në gjykatë.

Përsëritja e intervistave

Viktimat pyeten në mënyrë të kufizuar gjatë procesit të hetimit dhe vetëm atëherë kur është e nevojshme. Kur dalin fakte të reja, mbi të cilat ato nuk janë marrë në pyetje më parë, ato mund të pyeten përsëri. Sipas rregullave procedurale mbi marrjen në pyetje të viktimës (neni 153-154 KPP), si dhe duke respektuar parimin e mosriviktimizimit, viktimat nuk mund të ripyetet për fakte për të cilat ai/ajo ka dhënë deklaratime më parë. Gjatë hetimit penal viktimat pyetet nga oficeri i policisë gjyqësore dhe/ose nga prokurori i çështjes. Gjatë shqyrtimit gjyqësor viktimat pyetet në cilësinë e dëshmitarit nga prokurori, avokati mbrojtës, i akuzuari, si dhe nga pjesëtarët e trupit gjykues.

65 Ministria e Brendshme, zyra e koordinatorit kombëtar mbi luftën kundër trafikimit të personave, "Procedurat standarte të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimit", Tiranë 2011.

Mbrojtja e privatësisë dhe e sigurisë së dëshmitareve viktima gjatë dhe mbas procedimit

Ligji ka disa dispozita në mbrojtje të dëshmitares-viktimë gjatë procedimit penal.

- Gjatë gjyqit viktimat mund të dëgjojnë mbas dyerve të mbyllura, pa praninë e të dyshuarit dhe/ose përmes video-s ose lidhjeve audio, si dhe pa praninë e publikut, në mënyrë që të evitohen kontaktet ndërmjet viktimës dhe të akuzuarit, si dhe të mbrohet viktimja nga hakmarrja e personave që marrin pjesë në procesin gjyqësor. Dëshmia e viktimës gjatë hetimit penal mund të përdoret gjatë gjyqit, kështu që viktimja nuk duhet të dëshmojë përsëri.
- Gjykata mund të vendosë ta zhvillojë shqyrtimin gjyqësor me dyer të mbyllura kur mendohet e nevojshme për të mbrojtur sigurinë e dëshmitarëve, si dhe në rastin e marrjes në pyetje të të miturit (neni 340(1) c & ç KPP). I mituri mund të dëgjohej nga trupi gjykues pa praninë e publikut. Përjashtimi i medias gjithashtu nuk parashikohet specifikisht, por bie nën të njëjtin nen (neni 340 KPP; neni 7 i ligjit mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda).
- Gjyqi mund të zhvillohet me dyer të mbyllura kur është interesi i mbrojtjes së pjesëmarrësve në gjyq. Viktimja/dëshmitarët mund të pyeten në praninë e të dyshuarit dhe të avokatit të tij, pa pasur kontakt vizual dhe pa e bërë të njohur identitetin e viktimës tek i dyshuari dhe tek avokatët mbrojtës të tij (neni 7 & 8 i ligjit mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda).
- Dëshmitari mund të merret në pyetje në distancë, qoftë brenda ose jashtë vendit, përmes lidhjes audiovizive, në përputhje me rregullat e përcaktuara në marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe në dispozitat e KPP (neni 361(7) KPP).
- Kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se personi mund të jetë subjekt i dhunës, ose i kërcënimeve, gjykata mund të lejojë si provë pranimin e dëshmisë së viktimës gjatë fazës së hetimit paraprak. Kjo e bën të mundur kufizimin e pjesëmarrjes së viktimës së trafikimit në procesin gjyqësor,

64

duke marrë në konsideratë kompleksitetin e hetimit për këto vepra penale (neni 316(b) KPP).

- Gjatë hetimit, viktima dhe organizatat që mbështesin viktimën nuk janë të detyruara të nxjerrin adresën e viktimës apo strehëzën ku qëndron viktima. Në praktikë prokurori komunikon me strehëzën. Komunikimi përmes QNL-së gjithashtu ka qenë një mundësi, në rastet kur viktima nuk është e akomoduar në strehëz.

Në praktikën e Gjykatës së Krimeve të Rënda nenet⁶⁶ të cilat aplikohen më shpesh janë ato që lejojnë dëgjimin me dyer të mbyllura kur viktima merret në pyetje, si dhe kur evitohen kontaktet vizuale me të dyshuarin dhe me avokatin e tij mbrojtës. Mundësia e pranimit të dëshmisë së viktimës gjatë hetimit paraparak si provë në gjyq është aplikuar në të gjitha rastet kur ka një risk që viktima mund të jetë subjekt i kërcënimeve, ose kur viktimës i janë premtuar para në mënyrë që të tërheq akuzën penale, ose që të mos jap dëshmi.

Megjithatë nga monitorimi i seancave gjyqësore, është parë se ka seanca gjyqësore në të cilat të dhënat personale të viktimës bëhen publike.

Në rastin e B.Q.,– për shkak se vepra penale e prostitucionit për të cilën u dënua B.Q. nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës është e lidhur direkt me dinjitetin dhe moralin e B.Q. – QNL i kërkoi Gjykatës së Lartë që të marrë në konsideratë detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e individit nga përpunimi automatik i të dhënave personale (Konventa nr. 108), neni 3(2) dhe neni 6 dhe praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe të përfshiheshin në vendimin e gjyqit vetëm inicialet ose të kodoheshin të dhënat e identitetit të viktimës (sepse për QNL, ajo është një viktimë e pabarazisë në shoqëri dhe neni 113 i KP është antikushtetues). Gjykata e Lartë përdori gjatë gjithë procesit vetëm inicialet B.Q.

Programet e veçanta të mbrojtjes së dëshmitarit

Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë (i

66 Neni 340 i KPrP, “Rastet e gjykimit me dyer të mbyllura” dhe neni 8 i Ligjit mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda, “Pyetja e dëshmitarëve”.

ndryshuar)⁶⁷ siguron një program të veçantë mbrojtje, por ky program përdoret rrallë, sepse kushtet janë shumë strikte. Dëshmitari duhet të jetë në rrezik dhe ky rrezik duhet të jetë aktual, konkret dhe serioz. Në shumicën e rasteve viktimat, mbasi bëjnë denoncimin, mbrohen duke u akomoduar në strehëza. Ka vetëm një rast të Gjykatës së Krimeve të Rënda (vendimi akoma nuk është i formës së prerë) më 2013, në të cilin viktimat është përfshirë në programin e mbrojtjes së dëshmitarit.

Programi i mbrojtjes së dëshmitarit përfshin masat e mëposhtme:

- a. Ndryshimin e identitetit;
- b. Ndryshimin e rezidencës;
- c. Mbrojtje të përkohshme të identitetit, informacionit dhe dokumenteve të personit të mbrojtur;
- d. Deklarata të dëshmitarit nën një tjetër identitet dhe administrim të këtyre deklaratave me mjete speciale për deformimin e zërit, mungesën e pamjes dhe forma të tjera të përcaktuara nga ligji;
- e. Masa të veçanta fizike dhe teknike mbrojtjeje në vendin ku personi i mbrojtur banon, gjatë transportit, duke përfshirë gjithashtu situatat ku nevojitet një mbrojtje e tillë për përmbushjen e detyrimeve përkundrejt autoriteteve të drejtësisë;
- f. Mbrojtje dhe trajtim të veçantë në rastet kur bashkëpunëtori i drejtësisë është vendosur në burg si një masë sigurie për periudhën para gjyqit, ose kur është dënuar me burg;
- g. Rehabilitim social;
- h. Mirëmbajtje, ndryshim i vendit të punës dhe punësim i përkohshëm;
- i. Ndihmë financiare për periudhën e kohës ndërmjet dy punësimeve;
- j. Rikualifikim profesional;
- k. Dhënie këshillash dhe asistence ligjore të specializuar;
- l. Forma të tjera siç janë të përcaktuara nga ligji;

67 Ligji Nr.10173 i 22 tetorit 2009 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë", i ndryshuar.

66

Përveç dispozitave ligjore të përshkuara më sipër, ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë përshkruan në detaje masat e veçanta, mënyrën dhe procedurat për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, organizimin, funksionimin, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet agjensive përgjegjëse për propozimin, vlerësimin, aprovimin dhe aplikimin e masave të veçanta të mbrojtjes.

Masat e mbrojtjes së veçantë mund të mos zbatohen në një shkallë të tillë dhe në një mënyrë të tillë që do të çonte në përmirësimin e kushteve ekonomike të personit të mbrojtur si rezultat i zbatimit të këtyre masave. Masat e mbrojtjes së veçantë, si rregull, vendosen për një kohë të pacaktuar dhe mund të aplikohen gjatë të gjitha fazave të procedimit penal, po kështu edhe mbas mbarimit të tij. Zgjatja e masave të mbrojtjes së veçantë varet nga niveli i rrezikut, nga përshtatshmëria e personit të mbrojtur në lidhje me këto masa të veçanta mbrojtjeje, si dhe nga korrektësia e saj/tij në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe të kushteve të parashikuara në marrëveshjen e mbrojtjes. Rregullat dhe kriteret e detajuara mbi përmbajtjen, kuptimin, qëndrueshmërinë, mënyrën dhe procedurat që nxirren, si dhe përmirësimi i zbatimit të masave të veçanta të mbrojtjes, duhen përcaktuar me udhëzime të përbashkët të Prokurorit të Përgjithshëm, ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit të Drejtësisë.⁶⁸

Fëmijët

Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve është i aplikueshëm si për të rriturit, ashtu edhe për minorenët. Nëse personi i mbrojtur është një minoren, ose një i rritur të cilit i është kufizuar ose hequr aftësia për të vepruar, opinioni i saj/tij merret parasysh në lidhje me aksesin e saj/tij në program dhe me përmbajtjen e marrëveshjes, në përputhje me parimet e interesave të saj/tij më të larta dhe të aftësisë së saj/tij për të vepruar (neni. 19(5)) Në këto raste, aprovimi përfundimtar dhe firmosja e marrëveshjes kryhet nga prindërit e saj/tij ose nga kujdestari.

Dispozitat specifike të mëposhtme parashikohen në lidhje me mbrojtjen dhe trajtimin e dëshmitarëve-fëmijë:

68 Për më shumë detaje shih: <http://www.refworld.org/docid/4c20dd572.html> [i aksesuar më 5, 5, 2014].

- Intervistat kryhen pa vonesa të pajustificuara dhe në ambiente të përcaktuara për këtë qëllim.
- Numri i intervistave kufizohet sa më shumë që të jetë e mundur dhe vetëm atëherë kur është veçanërisht e nevojshme.
- Intervistat kryhen sa më shumë të jetë e mundur me të njëjtët persona gjatë gjithë procedimeve penale.
- Fëmija mund të shoqërohet nga dikush që është zgjedhja e tij/e saj.
- Dëgjimi ndodh pa praninë e publikut dhe të medias, përmes lidhjeve me video ose mjeteve të tjera të komunikimit.
- Parandalohet shpërndarja e çdo informacioni që mund të çojë në identifikimin e fëmijës.

Këto dispozita zbatohen në praktikë, gjithashtu.

5.4. E drejta për kompensim

Personat e trafikuar kanë të drejtën për kompensim të përshtatshëm dhe efektiv. Kjo përfshin të drejtën për kompensim për dëmet materiale dhe jomateriale që ato kanë vuajtur. Kompensimi për dëmet mund të përfshijë kostot e trajtimeve mjekësore, fizike, ose psikologjike; kostot që i janë dashur viktimës për terapi fizike dhe të lidhura me punën; kostot e nevojshme për transport, kostot për kujdesin ndaj fëmijës, apo kostot për qira shtëpie; të ardhurat e humbura dhe/ose rrogën/paratë që viktima i fitonte për trafikantin dhe detyrohej që t'ja dorëzonte atij; tarifa ligjore dhe kosto të tjera apo shpenzime të kryera; pagesën për dëme jomateriale, që janë shkaktuar nga stresi emocional, nga dhimbja dhe nga vuajtjet që ka pësuar viktima si rezultat i krimit; çfarëdo lloj kostoje apo humbje që i ka ndodhur viktimës si rezultat direkt i krimit.

Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi krimin e organizuar ndërkombëtar (neni 14(2) & 25(2)), Protokollin e Kombeve të Bashkuara (neni 6(6) për antitrafikimin dhe Konventa e KE mbi masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore (neni 15(3)) kërkojnë që shtetet të sigurojnë që ka një mundësi ligjore dhe praktike për

68

personat e trafikuar për të përfituar kompensim për dëmet e pësuar. Kjo përfshin edhe dëmet materiale edhe dëmet jomateriale.

Shtetet duhet që të sigurojnë gjithashtu që ka një dispozitë për pagesën e kompensimit nga shteti, aty ku një kompensim i tillë nuk mund të sigurohet nga trafikanti, d.m.th. përmes një fondi të viktimave. Një fond i tillë mund të financohet përmes përdorimit të asetëve të konfiskuara (Konventa e KE mbi masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, neni 15(4); Udhëzimet e OHCHR mbi të drejtat e njeriut dhe trafikimin e qenieve njerëzore, 4.4).

Neni 25 (2) i Konventës së KB mbi krimin e organizuar ndërkombëtar u kërkon shteteve që të sigurojnë që të ketë dispozita për konfiskimin e asetëve të trafikimit. Një mundësi prioritare do të ishte përdorimi i asetëve të konfiskuara për të kompensuar viktimat.

Një gjykim i rëndësishëm nga kjo pikëpamje është gjykim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në rastin e Rantsev kundër Qipros dhe Ruisë⁶⁹, në të cilin Gjykata u shpreh se trafikimi i qenieve njerëzore bie nën fushveprimin e nenit 4 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, pa qenë nevoja për të identifikuar nëse ai përbën skllavëri, robëri, apo punë të detyruar. Kjo do të thotë që shtetet kanë detyrimin pozitiv që jo vetëm të parandalojnë, procedojnë dhe mbrojnë, por gjithashtu edhe t'u japin viktimave kompensim efektiv.

Kompensimi përmes procedimeve penale

Viktimat mund të kërkojnë kompensim për dëmet materiale nga i padituri duke i bashkuar procedimit penal një padi civile në procesin penal. Kjo është e përcaktuar në nenin 61 të KPP "Padi civile në procesin penal":

Ai që ka pësuar dëm material nga vepra penale, ose trashëgimtarët e tij, mund të ngrenë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil, për të kërkuar kthimin e pasurisë dhe shpërbllimin e dëmit.

Sipas nenit 61 të KPP, vetëm dëmi material i shkaktuar ndaj viktimave të trafikimit mund të kërkohej në rastin penal. Sipas nenit 608 të Kodit Civil kompensimi për dëmet materiale mund të përfshijë në pagesën për:

69 ECHR (Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut), *Rantsev kundër Qipros dhe Ruisë*, Aplikim Nr. 25965/04, 7 janar 2010, i disponueshëm tek www.interights.org/rantsev.

- Kostot e trajtimeve mjekësore, fizike, psikologjike ose psikiatrike të kërkuara nga viktimat;
- Kostot e terapisë fizike dhe për shkak të profesionit, ose për rehabilitim, të kërkuara nga viktimat;
- Kostot e transportit të nevojshëm, kujdesit të përkohshëm për fëmijët, strehimit të përkohshëm, ose kostot e lëvizja e viktimës në një vend për rezidencë të përkohshme të sigurtë;
- Të ardhurat e humbura dhe pagesat përkatëse bazuar në ligjin kombëtar dhe në rregullat që lidhen me përcaktimin e pagës/ paratë që viktimat ka fituar për trafikantin;
- Tarifat ligjore si dhe kostot dhe shpenzime që ka pasur viktimat, duke përfshirë kostot që lidhen me pjesëmarrjen e viktimës në hetimin penal dhe në procesin e shqyrtimit gjyqësor;
- Çdo lloj kostoje tjetër apo humbjesh që ka pësuar viktimat si rezultat direkt i këtij krimi.

Fakti që viktimat nuk mund të kërkojnë dëm moral në procesin penal përfaqëson një pengesë serioze për t'u rregulluar, duke marrë në konsideratë që në rastin e trafikimit dëmi material shoqërohet me dëm moral të rëndë.

Nëse pretendimi pranohet, atëherë vetë viktimat është përgjegjëse të kërkojnë ekzekutimin e urdhrit. Në praktikë, edhe nëse pretendimi pranohet nga gjykata penale, është e pamundur për viktimat që ta ekzekutojnë këtë urdhër.

Gjykata Penale mund të vendosë veçimin e padisë civile dhe ta dërgojë atë në gjykatën civile sipas nenit 62 të Kodit të Procedurës Penale, i cili thotë:

Gjykata, me kërkesën e palëve ose kryesisht, mund të vendosë veçimin e padisë civile dhe dërgimin e saj në gjykatën civile, nëse gjykimi i saj vështirëson ose zvarrit procesin penal.

Kjo mund të bëhet ose me kërkesën e palëve, ose kryesisht, nëse gjykimi i akuzës civile sjell vështirësi, ose shkakton vonesa në procesin penal.⁷⁰

70 Shtojca Kodi i Procedurës Penale, sipas Ligjit nr.8813, datë 13.06.2002.

70

QNL nuk ka informacion për raste në të cilat padia për kompensim të çojë në një vendim kompensimi brenda procedurës penale. Në të gjitha rastet viktimat janë referuar tek gjykata civile.

Kompensimi përmes procedimit civil

Viktima mund gjithashtu të kërkojë kompensim përmes procedimit civil pranë një gjykate civile. Në këtë rast, viktima mund të kërkojë si dëmet materiale (në kuadrin e nenit 608 të Kodit Civil⁷¹), ashtu edhe dëmet morale. Sipas nenit 625⁷² të Kodit Civil dëmet morale konsistojnë në pagesa për dëmet jomateriale që rrjedhin nga dëmtimi moral, fizik ose psikologjik, ankthi emocional, dhimbjet dhe vuajtjet që viktima ka pasur si rezultat i krimit të kryer kundër saj/tij.

QNL ka aplikuar këto dispozita në rastin e D.S., një viktime minorene e trafikimit. Në emër të D.S., QNL, bazuar në nenin 128(b) të KP, ngriti një padi civile në procesin penal kundër keqbërësit për të kërkuar kompensim për dëmet materiale. Gjykata penale vendosi që ta ndajë padinë civile dhe e dërgoi atë në gjykatën civile. Procesi në gjykatën civile u mbajt mbasi vendimi penal mori formën e prerë, pra, mbas rreth 18 muajsh. Gjykata civile (me vendimin nr. 1202 të dates 19.02.2010) dënoi të paditurin dhe e detyroi që t'i paguante D.S. kompensim për dëme morale në masën e 40.000 eurove. QNL gjithashtu kërkoi kompensim edhe për paratë që viktima kishte fituar për trafikantin dhe që ishte detyruar prej tij që t'ja dorëzonte atij, por gjykata civile dha dënimin vetëm për dëmin moral. Vendimi, megjithatë, akoma nuk është zbatuar, së pari sepse, zyra e përmbaramit ka taksa të larta, në këtë rast 3% të vlerës që është për ekzekutim, e cila duhet paguar që më parë. Kjo shumë parash është e pamundur të paguhet nga viktimat. Së dyti, ka vështirësi në zbatim sepse pronat e të pandehurit u konfiskuan nga shteti.

- 71 Neni 608 i Kodit Civil mbi përgjegjësinë për shkakimin e dëmit: "Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkakuar. Personi që ka shkakuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cënimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik, ose nga zakonet e mira.
- 72 Neni 625 i Kodit Civil mbi përgjegjësinë për dëmin jopasuror: "Personi që pëson një dëm jopasuror ka të drejtë të shpërblehet kur: a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit, të integritetit fizik, ose psikik të tij; b) është cenuar nderi, personaliteti ose reputacioni i tij; c) është cenuar e drejta e emrit; ç) është cenuar respektimi i jetës private; d) është cenuar kujtimi i një të vdekuri. Në këtë rast bashkëshorti i personit të vdekur, ose të afërmit të tij deri në shkallë të dytë mund të kërkojnë shpërblimin e dëmit jopasuror". Kjo e drejtë e parashikuar në paragrafin e përmendur më sipër nuk është e trashëgueshme.

Ekzekutimi

Në total, QNL ka drejtuar pesë raste mbi kompensimin, nga të cilat dy janë fituar, por nuk janë ekzekutuar.

Ekzekutimi është shumë problematik. E para, sepse paditësi/viktima duhet të paguajë që në fillim 3% të kompensimit të caktuar si taksë për zyrën e përmbarimit, gjë e cila është e pamundur për viktimat e trafikimit. Së dyti, nëse asetet që rrjedhin nga krimi konfiskohen nga shteti, nuk ka prona që mund të përdoren për të ekzekutuar urdhrin. Në teori, asetet e konfiskuara mund të përdoren për të kompensuar viktimat mbi bazën e aktit antimafia. Në praktikë, megjithatë, kjo nuk ka qenë kurrë e suksesshme.

Nuk ka ndonjë rast të njohur në të cilin viktimës i është akorduar kompensim i dëmeve *dhe de facto* e ka marrë këtë kompensim për dëmet.

Fondi shtetëror

Megjithëse zyrtarisht ekziston një skemë shtetërore e kompensimit, në praktikë kjo nuk funksionon. Ligji “Mbi parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit përmes masave parandaluese kundër pasurisë” (neni. 37(c) Ligji Nr. 10192, 3. 12. 2009) vë në dispozicion një fond të veçantë, por përcakton se ky fond do të përdoret për asistencë ndaj viktimave të krimit të organizuar dhe të dhunës, si dhe për të promovuar programe sociale për këto kategori.

Në praktikë nuk ka ndonjë rast në të cilin viktimat e trafikimit të kenë përfituar nga ky fond. Në shumicën e rasteve viktimat kërkojnë kompensim përmes një padie civile në procesin penal.

E drejta për të kërkuar kompensim bazuar tek legjislacioni i punës

Legjislacioni i punës mund të ofrojë mundësi për të kërkuar kompensim për shfrytëzim në punë. Mekanizmat kombëtarë që rregullojnë standardet për punësim duhet gjithashtu të lejojnë inspektorët e punës që të ngrenë padi kundër punëdhënësve për pagesë kompensimi (p.sh. në rastet e pagave që nuk paguhen, ose të dëmeve të shkaktuara në punë).

72

Në praktikë, megjithatë, kjo nuk ka ndodhur kurrë. Në këtë aspekt, legjislacioni ynë ka nevojë për përmirësim, në mënyrë që të japë mbështetje për personat e trafikuar.

Pengesat kryesore për viktimat për të fituar kompensim për dëmet

Nuk ka ndonjë lehtësim procedural për të kërkuar kompensim të dëmeve materiale përmes procesit penal. Gjithashtu, pavarësisht se ka një skemë shtetërore kompensimi, në praktikë, asnjë viktimë trafikimi nuk ka përfituar nga ky fond.

Tjetër pengesë për kërkesën për kompensim janë tarifat gjyqësore. Megjithëse që nga ndryshimi në ligjin “Për ndihmën juridike”, viktimat e trafikimit përjashtohen nga pagesa e taksave gjyqësore, në praktikë jo të gjitha palët janë të njohura me këtë ndryshim.

Gjykata Kushtetuese (vendimi Nr. 7, datë 27 shkurt 2013) ka udhëzuar që gjykata mund të vendosë mbi përjashtimin nga shpenzimet e gjyqit qytetarët të cilët i adresohen gjykatës për të zgjidhur një çështje civile. Kjo vendoset nga gjykata mbas një shqyrtimi të të gjithë dokumentacionit të kërkuar që është paraqitur nga viktimat.

Nëse viktimat aplikojnë tek Komisioni Shtetëror për Ndihmë Juridike, ajo/ai mund të përfitojë si viktimë e trafikimit. Nëse ajo/ai nuk ka aplikuar tek Komisioni Shtetëror për Ndihmë Juridike, aplikohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese. QNL është e opinionit se kur viktimat dorëzojnë dokumentin që ajo/ai është viktimë e trafikimit, ky dokument duhet të jetë i mjaftueshëm për gjykatën e rrethit gjyqësor që të mos diskutojë aftësinë e viktimës për të paguar.

Ndryshimet e nevojshme më urgjente janë:

- Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale për të lehtësuar procedurat për bashkimin e padisë civile për kompensim me rastin penal.
- Ndryshimet në legjislacionin e brendshëm për të bërë të mundur që viktimat të marrin kompensim nga skema shtetërore.⁷³

73 Ligji nr. 10192 i 3 dhjetor 2009 “Mbi parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

- Zbatimi i dispozitës që përjashton viktimën e trafikimit nga pagesa e taksave gjyqësore dhe nga shpenzimet e gjyqit.

5.5. Mosprocedimi dhe mosndëshkimi i personave të trafikuar

Viktimat e trafikimit nuk duhet të procedohen ose të ndëshkohen për prostitucion ose për akte të tjera të paligjshme, të cilat ato kanë qenë të detyruara t'i kryenin si rezultat direkt i trafikimit të tyre.

Neni 26 i Konventës së KE kërkon nga shtetet të ofrojnë mundësinë për të mos imponuar dënime ndaj viktimave të trafikimit. Një dispozitë e ngjashme gjendet në nenin. 8 të Direktivës 36/2011/EU e cila detyron shtetet që të marrin masat e nevojshme për të siguruar që autoritet kompetente kombëtare të kenë të drejtë të mos procedojnë, ose të mos imponojnë dënime mbi viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore për përfshirjen e tyre në aktivitetet kriminale për të cilat ato kanë qenë të detyruara për t'i kryer si një pasojë direkte e të qenit të trafikuar.

Situata aktuale

Në vitin 2013, një dispozitë mos-ndëshkuese u fut në Kodin Penal (Ligji 144/2013⁷⁴). Neni 52(a) mbi përjashtimin ose uljen e dënimit për bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe viktimat thotë:

Personi i dëmtuar nga veprat penale që lidhen me trafikimin e personit mund të përfitojë përjashtimin nga dënimi, për kryerjen e veprave penale gjatë periudhës së trafikimit dhe në masën që ka qenë i detyruar t'i kryejë ato veprime apo mosveprime të kundërligjshme.....

Zbatimi i kësaj dispozite nuk është akoma i qartë. Një faktor që e komplikon zbatimin e saj është që çështjet e mundshme të trafikimit fillimisht shkojnë në gjykatat e rretheve gjyqësore, të cilat e kualifikojnë atë si një çështje të trafikimit, ose si një rast të shfrytëzimit të prostitucionit. Në rastin e trafikimit, çështja i

74 Ligji Nr. 144/2013 "Mbi disa shtesa dhe ndryshime të Ligjit Nr.7895 të 27 janarit 1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë".

74

referohet Gjykatës së Krimeve të Rënda, në rastin e shfrytëzimit të prostitucionit çështja shqyrtohet nga gjykata e rrethit gjyqësor. Gjykata e Krimeve të Rënda e njej përkufizimin e trafikimit, por kjo nuk aplikohet tek (të gjitha) gjykatat e rretheve gjyqësore. Veçanërisht në rastet e trafikimit të brendshëm tentohet që ato të konsiderohen dhe të procedohen si prostitucion, ose si vepra penale të lidhura me prostitucionin nga gjykatat e rretheve gjyqësore. Për më tepër, ndodh që policia identifikon një viktimë të mundshme të trafikimit, por që prokurori e kualifikon atë si një rast të shfrytëzimit të prostitucionit.

Raporti mbi trafikimin e personave, i vitit 2013, i Departamentit Amerikan të Shtetit, vë re se autoritetet shqiptare akoma i trajtojnë viktimat e trafikimit si të dyshuara për prostitucion dhe në disa raste viktimat gjithashtu janë dënuar për prostitucion.

5.6. Mosndalimi i personave të trafikuar

Personat e Trafikuar nuk duhet të mbahen të ndaluar, ose nuk duhet të mbahen në strehëza ose në qendra të tjera bamirësie të mbyllura.

Ndalimi në strehëza të mbyllura

Ka tri strehëza në Shqipëri që akomodojnë viktimat e trafikimit.

- Qendra e Linzës: është një qendër e mbyllur shtetërore vetëm për viktimat e trafikimit me risk të lartë. Viktimat mbahen të mbyllura si dëshmitare. Ato kanë avokatin e tyre dhe profesionistë në dispozicion.
- Qendra “Të ndryshëm dhe të barabartë” në Tiranë.
- Qendra “Vatra” në Vlorë, që akomodon si viktimat e dhunës në familje, ashtu edhe viktimat e trafikimit. Më parë, kjo qendër akomodonte vetëm viktima të trafikimit, por për mungesë të fondeve ajo tani akomodon, gjithashtu, edhe viktima të dhunës në familje.

Ka pak informacion në lidhje me kushtet në qendrën e Linzës. Viktimat që referohen në QNL janë kryesisht të referuara nga Qendra psikosociale “Vatra” në Vlorë dhe Qendra “Të ndryshëm dhe të barabartë” në Tiranë.

5.7. Periudha e reflektimit, leja e përkohshme dhe e përhershme e qëndrimit dhe azili

Viktimat kanë të drejtën për një periudhë që të marrin veten dhe të reflektojnë. Viktimat pa dokumenta/migrante kanë të drejtën për një leje të përkohshme qëndrimi për kohën e procedimeve penale dhe të procedimeve të tjera, kur në fund të periudhës së reflektimit, ato vendosin që të bashkëpunojnë me autoritetet. Nëse kthimi do të vinte jetën dhe sigurinë e tyre në rrezik, personat e trafikuar kanë të drejtën që të aplikojnë për azil ose për leje qëndrimi për arsye humanitare.

Konventa e KE mbi masat kundër trafikimit (neni. 12-14), Direktiva e BE e vitit 2004 mbi lejen e përkohshme të qëndrimit për viktimat e trafikimit (neni. 6-9)⁷⁵, si dhe Direktiva 2011/36/EU mbi trafikimin (neni 11 (1)) u kërkojnë shteteve anëtare që t'u japin personave të trafikuar një periudhë reflektimi për të paktën 30 ditë, për të marrë veten dhe për të marrë një vendim të bazuar në informim, në lidhje me bashkëpunimin me autoritetet investiguese, si dhe leje qëndrimi të përkohshme për kohëzgjatjen e procedurave penale, apo të procedurave të tjera ligjore kur ato vendosin të bashkëpunojnë. Gjatë kohës së reflektimit viktimat duhet të kenë akses tek asistencë materiale, mjekësore, psikologjike dhe ligjore. Nëse u jepet një leje e përkohshme qëndrimi ato duhet të kenë akses në tregun e punës, në trajnimet profesionale dhe në shkollim. Periudha e reflektimit aplikohet si për viktimat e trafikimit që ndodh brenda kufijve të një vendi, ashtu edhe për viktimat e trafikimit që ndodhen jashtë kufijve të vendit.

Situata aktuale

Sipas ligjit "Për të huajt" (Ligji nr. 108/2013, neni 53 (1)b: "Lëshimi i lejes së qëndrimit për raste humanitare") autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin pajis të huajin me lejeqëndrimi të përkohshme, nëse i huaji është një viktimë, ose viktimë e mundshme e trafikimit.

75 Direktiva e Këshillit [2004/81/EC](#), e 29 prillit 2004, në lidhje me lejen e qëndrimit që u jepet qytetarëve nga vendet e treta, që janë viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore, ose që kanë qenë subjekte të një veprimi për lehtësimin e migracionit të paligjshëm, të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente.

76

E drejta e viktimave të huaja të trafikimit për t'u dhënë lejeqëndrimi është formuluar në Vendimin nr. 513, datë 13.6.2013 "Mbi përcaktimin e kritereve, procedurave dhe dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë".

Nuk ka eksperiencë në zbatimin e kësaj dispozite, sepse deri tani asnjë viktimë trafikimi e huaj nuk është identifikuar në Shqipëri.

5.8. Rikthimi në atdhe dhe garantimi i mospërsëritjes

Viktimat kanë të drejtën, nëse ato e dëshirojnë një gjë të tillë, të kthehen në vendet e tyre pa ndonjë vonesë të panevojshme apo të pajustificuar, duke treguar kujdes për sigurinë e tyre. Siguria e personit të trafikuar dhe e familjes së tyre duhen marrë parasysh në çdo vendim për rikthim. Viktimat mund të mos kthehen kur ka një rrezik serioz që ato do të bëhen subjekt i persekutimit, torturës ose formave të tjera të keqtrajtimit (parimi i mos-kthimit).

Procedurat Standarde të Veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit dhe të viktimave të mundshme të trafikimit parashikojnë asistencë për kthimin vullnetar. Kjo mund të ketë lidhje si me ndihmën për kthim vullnetar të qytetarëve shqiptarë të identifikuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, po ashtu edhe me ndihmën për viktimat e huaja për t'u kthyer në vendin e tyre të origjinës.

Në rastin e fëmijëve, anëtar i autoritetit përgjegjës nga Ministria e Punëve të Jashtme vendos kontakte me prindërit/kujdestarin ligjor të fëmijës dhe merr autorizimin e prindërve/këshilltarit ligjor për udhëtimin e fëmijës. Përpara kthimit të viktimave shqiptare të trafikimit, duhet bërë vlerësimi i situatës sociale, ekonomike dhe i situatës së sigurisë.

Në rast se raporti i vlerësimit nga shteti i origjinës tregon që kthimi i fëmijës pranë familjes, ose pranë një institucioni për kujdesin e fëmijëve në vendin e origjinës, nuk është i sigurtë dhe është i papërshtatshëm, rasti rishikohet nga autoriteti përkatës dhe gjendet një zgjidhje afatgjatë.

PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIME

Përmbledhje

Legjislacioni shqiptar është hartuar pjesërisht, në përputhje me standardet ndërkombëtare për sa u përket të drejtave të viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore. Megjithëse kuadri legjislativ është përmirësuar, të drejtat e viktimave në procesin penal nuk janë parashikuar në legjislacion, e për rrjedhojë ka shumë mangësi edhe në praktikë. Të drejtat që duhet të parashikohen në legjislacion përfshijnë të drejtën e informacionit, ndihmën juridike falas, kompensimin dhe mbrojtjen e privatësisë dhe sigurisë, para, gjatë dhe mbas procedimeve penale.

Viktimat nuk përfaqësohen me avokat dhe nuk informohen në të gjitha fazat rreth të drejtave të tyre ligjore, duke filluar me momentin e identifikimit. Deri tani nuk ka rast, që viktimës së trafikimit t'i jepet kompensim dhe *de facto* ta marrë atë.

Një tjetër çështje shqetësuese është ndëshikimi i vazhdueshëm i prostitutave për shkak të kriminalizimit të parashikuar në nenin 113 të Kodit Penal, pavarësisht standardeve ndërkombëtare dhe thirrjeve të Komitetit CEDAË për ta shfuqizuar këtë nen. QNL ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese

Nuk ka në fuqi ndonjë sistem mbi botimin e praktikës gjyqësore që lidhet me trafikimin e qenieve njerëzore.

Zhvillime pozitive janë ndryshimet e fundit në ligjin për ndihmën juridike, që u japin të drejtën për ndihmë juridike falas viktimave të trafikimit dhe vendosin përjashtimin e tyre nga pagesat e taksave gjyqësore dhe shpenzimet e gjyqit. Megjithatë, në mënyrë që të zbatohen aktualisht këto ndryshime po veprohet me ngadalësi.

78

Forcimi i kapacitetit të profesionistëve të sistemit gjyqësor, si gjyqtarë dhe prokurorë, përmes trajnimeve të vazhdueshme, është kryer në mënyrë të vazhdueshme.

Si pas raportit të trafikimit të personave të vitit 2013 të Departamentit Amerikan të Shtetit⁷⁶, agjencitë shqiptare të zbatimit të ligjit kanë përmirësuar kuptimin e tyre për një qasje të orientuar nga viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

Me ftesë të zyrës së koordinatorit kombëtar të antitrafikimit organizatat joqeveritare kanë kontribuar në zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit përmes aktiviteteve konkrete.

Rekomandime

Viktimat e trafikimit duhet të kenë akses efektiv për kompensim, si për kompensimin e dëmeve materiale, ashtu edhe për kompensimin e dëmeve jomateriale. Kjo kërkon ndryshime në Kodin e Procedurës Penale që të parashikojë procedura të qarta për kërkimin e dëmit gjatë procesit penal. Shpërblimi i dëmit të ardhur nga kryerja e veprës penale, nga procesi penal, duhet të përfshijë jo vetëm dëmin material, por edhe atë moral.

Ndryshime të rëndësishme ka nevojë të bëhen edhe në legjisllacionin e brendshëm, me qëllim krijimin e skemave reale shtetërore të kompensimit të viktimave të dëmtuara nga vepra penale.

Ka nevojë të parashikohen në Kodin e Procedurës Penale dispozita që përcaktojnë qartësisht procedurat dhe organin kompetent që do të ndjekë garantimin e të drejtës për informim të viktimave të trafikimit, si të ndihmës juridike që duhet t'u afrohet atyre.

Mbrojtja e të dhënave personale të viktimës së trafikimit duhet përmirësuar, për ta sjellë atë në përputhje me standardet e Konventës 108 të Këshillit të Evropës.

Roli i Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike ka nevojë të forcohet, në mënyrë që të mbështeten viktimat e trafikimit, duke përfutur nga ndihma juridike falas.

76 http://www.punetebrendshme.gov.al/files/priorities_files/06202014_English_TIP.pdf.

Avokatët kanë nevojë të trajnohen për të dhënë ndihmën juridike të specializuar për viktimat e trafikimit. Roli i avokatit, veçanërisht në kontaktin e parë të viktimës me autoritetet, ka nevojë të përfshihet në procedurat standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.

Trajnimet për profesionistët e sistemit të drejtësisë kanë nevojë të organizohen qëndrueshëm. Për më tepër, një bashkëpunim më i mirë rekomandohet ndërmjet profesionistëve të sistemit të drejtësisë dhe organizatave joqeveritare që fokusohen tek promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.

Në mënyrë të ngjashme, bashkëpunimi ndërmjet zyrës së koordinatorit kombëtar antitrafikim dhe organizatave joqeveritare ka nevojë të forcohet përmes veprimeve konkrete.

Rekomandohet të ngrihet një sistem botimi i praktikave gjyqësore mbi trafikimin e qenieve njerëzore.

ANEKSI 1

Roli i OJF-ve. Praktika e Qendrës psikosociale “Vatra”.

Qendra psikosociale “Vatra” ofron ndihmë ligjore falas për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Në kuadrin e kësaj ndihme falas, ofrohet *informacion dhe këshillim për përfitueset*, ku përfshihen së pari, seanca dhe takime informuese në grup të organizuara nga avokatet e qendrës. Disa nga diskutimet kryesore të këtyre takimeve kanë qenë: “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, e drejta për dëmshpërblim dhe kompensim, ligji për barazinë gjinore, ligji për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, rregullore dhe procedura mbi regjistrimin e fëmijëve, etj. *Së dyti*, ajo konsiston në ofrimin e këshillimit individual të përfituesve, të cilët kanë denoncuar autorin e veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore. Po kështu, informimi i përfituesve për të drejtat e tyre realizohet nga ana e stafit të Vatrës prej kontaktit të parë me to.

Asistenca ligjore e drejtpërdrejtë konsiston në vlerësimin e nevojave të përfituesve për ndihmë ligjore falas dhe hartimin e planit të asistencës, bazuar në standardet shtetërore; në këshillimin dhe shoqërimin e përfituesit nga avokati dhe psikologu ose punonjësi social gjatë marrjes në pyetje në polici, prokurori, gjykatë, zyrat e gjendjes civile dhe institucione të tjera, sipas problemeve; në shoqërimin dhe mbështetjen e përfituesve në të gjitha seancat gjyqësore nga ana e psikologut dhe avokatit; në informimin e përfituesit në lidhje me vazhdimësinë e procesit penal për trafikantin, në regjistrimin e përfituesve dhe dhënien e dokumenteve të identifikimit, si certifikatat dhe kartat e identitetit; në regjistrimin e fëmijëve të përfituesve në gjendjen civile dhe dhënien e dokumenteve përkatëse; në asistencën në proceset gjyqësore civile si zgjidhja e martesës, problemet e pronësisë, etj.

Disa nga problemet e identifikuar në adresimin e këtyre çështjeve ose në ofrimin e këtij shërbimi janë:

Mungesa e informacionit të përfituesve për të drejtat e tyre të parashikuara në legjislacionin kundër trafikimit, në ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve, të drejtën për dëmshpërblim dhe kompensim, etj.; Mungesa e dokumentacionit (certifikatat, karta e identitetit); mosregjistrimi në gjendjen civile (fëmijët e përfitueses, por edhe vetë përfituesja në disa raste); korrupsioni në strukturat e zbatimit të ligjit; paragjykimi i përfituesve nga vetë strukturat e zbatimit të ligjit; mungesa e punonjësve socialë/psikologëve pranë zyrave të prokurorisë ose gjykatës, të cilët do të mbështetnin nga ana psikologjike përfituesen; kohëzgjatja e proceseve gjyqësore (madje deri në 3 vjet) i bën përfituesit të humbasin durimin për të qëndruar në strehëz për arsye sigurie; përballja e viktimës së trafikimit ose pjesëtarëve të familjes së saj me trafikantin gjatë procesit të hetimit në zyrën e prokurorit dhe gjykimit në gjykatë; trafikimi i brendshëm në disa raste nga ana e strukturave të policisë së shtetit konsiderohet si “shfrytëzim prostitucioni” dhe jo si trafikim.; çështjet e denoncimit të viktimave të trafikimit të shfrytëzuara brenda vendit në shumë raste konsiderohen nga ana e policisë dhe prokurorisë së rretheve si “shfrytëzim prostitucioni” dhe jo si “trafikim i personave”, ndërkohë që çështjet e denoncimit të viktimave të trafikimit të shfrytëzuara jashtë vendit trajtohen si vepër penale e trafikimit të personave. Një tjetër problem që është evidentuar kryesisht vitet e fundit është se së bashku me shfrytëzuesin në disa raste janë dënuar dhe vetë viktimat e trafikimit dhe konkretisht : shfrytëzuesi “për shfrytëzim prostitucioni” dhe viktimat për “ushtrim prostitucioni”. Nga praktika ka rezultuar nevoja për forcimin e kapaciteteve të policisë gjyqësore, prokurorisë dhe gjykatave të rretheve gjyqësore, në lidhje me legjislacionin kundër trafikimit.

Disa nga vështirësitë dhe sfidat e identifikuar nga stafi i qendrës:

- Moszbatimi i ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve (nga viti 2005 vetëm një viktimë trafikimi është përfshirë në këtë program) krijon rrezik për jetën e përfituesve. Si rezultat, në shumë çështje viktimat nuk denonconin, por edhe kur denonconin, ato tërhiqeshin në mes të procesit, për shkak të frikës për jetën e tyre dhe të familjarëve të tyre.

82

- Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore nuk kanë përfituar dëmshpërblim si rezultat i barrës së taksave gjyqësore. Sipas Kodit të Procedurave Civile, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore duhet të paguajnë tarifën gjyqësore kur kërkojnë dëmshpërblim në gjykatë, e cila është 1% e vlerës së objektit të padisë. Duke marrë në konsideratë situatën social-ekonomike të viktimave të trafikimit, asnjëra prej tyre nuk është në gjendje të paguajë tarifën gjyqësore. Bazuar në eksperiencën e Qendrës psikosociale “Vatra”, gjatë viteve 2010 -2011, tre nga viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore janë tërhequr nga kërkesa e tyre, në momentin kur u është dashur të paguajnë taksat gjyqësore. Kështu, edhe në një çështje të mbështetur nga QNL në vitin 2010, viktimat ka fituar të drejtën për kompensim, por vendimi i gjykatës vazhdon të mbetet i paekzekutuar.
- Përballja e viktimës me trafikantin/trafikantët gjatë procesit gjyqësor ose në zyrën e prokurorisë dhe përballja me paragykimet e përfaqësuesve të këtyre institucioneve sjellin probleme psikologjike që reflektohen tek ulja e besimit të viktimave në institucionet e drejtësisë, problemet e sjelljes dhe komunikimit me stafin, frika dhe pasiguria për jetën, etj. Në këto raste viktimat rrezikohen të përballen me fenomenin e riviktimizimit.
- Shërbimi ligjor i ofruar ka kosto të lartë dhe përfshin koston e stafit, transportin, pagesën për dokumentet e përfituesit etj.
- Situata e rënduar psikologjike gjatë qëndrimit në strehëz të viktimës së trafikimit në pritje të përgjigjes nga gjykata e apelit për vendimin e gjykatës së shkallës së parë që e ka penalizuar për “ushtrim prostitucioni”.

Disa aspekte pozitive dhe suksese të kësaj qasjeje janë si më poshtë:

- Rritja e ndërgjegjësimit të përfituesve për të drejtat e tyre si dhe rritja e numrit të viktimave të cilat denoncojnë trafikantët.
- Zyra e Prokurorisë së Krimeve të Rënda ka një strukturë të specializuar kundër trafikimit. Dy prokurore femra trajtojnë të gjitha çështjet e denoncuar nga viktimat e trafikimit. Gjithashtu, një koordinator për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore punon pranë kësaj zyre. Zyra e Prokurorisë së Përgjithshme është përfshirë në Mekanizmin Kombëtar të Referimit.

- Prokuroria e Përgjithshme është tashmë anëtare e Mekanizimit Kombëtar të Referimit për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit/ të mundshme të trafikimit, rishikuar dhe nënshkruar në vitin 2012.
- Krahasur me vite të mëparshme, gjatë dy viteve të fundit ka një përmirësim të zhvillimit të procesit të identifikimit të viktimave të trafikimit të shfrytëzuara brenda vendit nga ana e strukturave të policisë së shtetit. Nëse vite më parë, të gjitha viktimat e shfrytëzuara brenda vendit identifikoheshin si raste të shfrytëzuara për prostitucion, gjatë vitit të fundit bazuar dhe në Procedurat Standarte të Veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit/të mundshme të trafikimit nga ana e policisë dhe shërbimit social këto raste janë identifikuar si “viktima trafikimi”.
- Ndryshime të rëndësishme në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë u bënë në maj 2013 me ligjin numër . 144/2013 “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7895 datë 27.01.1995.

Disa rekomandime:

- Rekomandohet përmirësimi i punës së oficerëve të policisë gjyqësore në identifikimin e trafikimit të brendshëm, trafikimit të fëmijëve dhe referimin e këtyre çështjeve në zyrën e Prokurorisë së Krimeve të Rënda.
- Rekomandohet përgatitja e një projektligji kundër trafikimit, i cili përcakton edhe mbrojtjen e viktimave, krahas dënimit të trafikantëve.
- Është shumë i rëndësishëm caktimi i një avokati për viktimat e trafikimit, i cili do të ofronte ndihmë ligjore falas, përfshirë shoqërimin dhe përfaqësimin e tyre në gjykatë.
- Është shumë e rëndësishme caktimi i një psikologu në zyrën e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, që të mbështesë emocionalisht viktimat e trafikimit gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor.
- Rekomandohet forcimi i kapaciteteve të prokurorisë, gjykatave, policisë gjyqësore, etj., nëpërmjet organizimit të trajnimeve të vazhdueshme.

BIBLIOGRAFI

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji 8417, datë 21.10.1998.
2. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, e ratifikuar me Ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002.
3. Protokollu "Kundër kontrabandimit të migrantëve me rrugë tokësore, detare dhe ajrore", që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002.
4. Protokollu "Mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve" në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr.8920, datë 11.07.2002.
5. Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, CEDAW, 1979, e ratifikuar me ligjin nr. 7767, datë 09.11.1993.
6. Konventa ndërkombëtare për ndalimin e e trafikimit të grave dhe fëmijëve (Gjenevë 1921), dhe protokollu amendues i saj.
7. Konventa për ndalimin e trafikut të grave në moshë madhore, përfunduar në Gjenevë më 1933 dhe protokollu amendues i saj.
8. Konventa për ndalimin e trafikut të personave dhe shfrytëzimit të prostitucionit të të tjerëve dhe protokollu final i saj më 1950.
9. Konventa e Këshillit të Evropës mbi kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme, ratifikuar me ligjin nr. 9265, datë 29.07.2004.
10. Konventa e Këshillit të Europës "Për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore", ratifikuar me ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006.

11. Deklarata e parimeve bazë të drejtësisë për viktimat e krimit dhe të abuzimit me pushtetin.
12. Direktiva e Këshillit të BE-së “Për kompensimin e viktimave të krimit”.
13. Direktiva 36/2011/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 5 prill 2011 mbi parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij, duke zëvendësuar Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA.
14. Komiteti CEDAW, vërejtje përmbyllëse, 2003 dhe 2010.
15. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i aprovuar me ligjin 7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar.
16. Kodi i Procedurës Penale, Ligji 7905, datë 21.03.1995, i ndryshuar.
17. Kodi i Familjes, Ligji nr. 9062, datë 08.05.2003.
18. Kodi i Punës, Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, ndryshuar me ligjin 8085, datë 13.03.1996, ndryshuar me ligjin 9125, datë 29.07.2003.
19. Ligji nr. 9110, datë 24.07.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”.
20. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.
21. Ligji nr. 10039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, i ndryshuar.
22. Kodi i Procedurës Penale (KPP) i Republikës së Shqipërisë.
23. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.
24. Ligji nr. 10039 datë 22 dhjetor 2008 “Për ndihmën juridike”.
25. Ligji nr.108/2013, “Për të huajt”.
26. Ligji nr. 9887 datë 10 mars 2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
27. Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.
28. Ligji nr. 10173 datë 22 tetor 2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, ndryshuar me ligjin nr.10461, datë

86

- 13.09.2011, “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10173, datë 22.10.2009, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”;
29. Ligji nr. 10192 datë 3 dhjetor 2009 “ Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”;
30. Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar. Ligji nr. 10252 datë 11 mars 2010 “Mbi disa ndryshime në ligjin nr. 9355 datë 10 mars 2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”;
31. Ligji nr. 23/2012 “Mbi disa ndryshime në ligjin nr. 7895 datë 27 janar 1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”.
32. Ligji nr. 144/2013, “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.
33. Rezoluta e Parlamentit Evropian datë 26 shkurt 2014 mbi shfrytëzimin seksual dhe prostitucionin dhe impaktin mbi barazinë gjinore (2013/2103(INI)).
34. Vendimi nr. 582, datë 27.07.2011, aprovimi i Procedurave Standarte të Veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit/viktimave të mundshme të trafikimit.
35. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 195, datë 11.04.2007, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar, ose në rrezik trafikimi”.
36. Jurisprudenca e gjykatave të niveleve të ndryshme.
37. Dosje të klientëve të mbështetur me ndihmë juridike falas nga avokatët e QNL.